

KULTURA ISLAME

ORGAN' I KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR
E Përmuejshme Fetare, Filozofike, Letrare, Morale e Shoqnore

PËRMBAJTJA:

1. Islamizmi dhe Gruaja	Faqe	83
2. Ç' vend zën Kurani në pikpamje legjislatoni?	"	87
3. Problemi fetar dhe Filozofia	"	92
4. Besnikija shoqnore	"	98
5. Familja	"	107
6. Shqiptarizmi jashta dhe mbrenda Atdheut	"	110
7. Në Gjykatoren e Halifes Umer	"	115
8. Jehu i Poezisë	"	117
9. Qarkore	"	118
10. Të ndryshme	"	122

Asht Ai, i Cili çoi të Dërguemin e Tij me udhëheqie e fé të vërtetë, që e bân të triumfojë mbi çdo besim (Kurani).

DREJTIMI:
KULTURA ISLAME
TIRANË

DREJTOR PËRGJEGJËS: S. BEGA
REDAKTOR: SH. PUTRA

„KULTURA ISLAME”

E PËRMUEJSHME FETARE-KULTURALE

ZYRA E REVISTËS: NË QENDRËN E KOMUNITETIT MUSLIMAN
SHQIPTAR — TIRANË

P A J T I M E T

Përmbrenda, për një vit		Fr. ari 2.40
Përjashta,	»	» 3.—
Për Studentë	» . ,	» 2.—

Dorëshkrimet, të botuara ose jo, nuk kërthehen
Revista mban të drejtën e çdo ribotimi



ISLAMIZMI DHE GRUAJA

PËR të dhënë një mendim të qartë mbi këtë thezë do të mjaftonte t'i hedhim një sy të qartë historisë përgjithësisht, gjë që do t'a ndihmonte shumë shvillimin e saj, mandej do të na ndihmonte më shumë të nxjerrim në shesh të vërtetat islame, d. m. th. çka thotë Islamizmi mbi gruanë.

Do të mjaftojshim t'a fillojshim themën t'onë me Athinën, në të cilën në kohët e vjetra qe shvilluar një qytetërim shumë i math. Në Athinë, si që na flet historia, gruaja përdoreshte në një mënyrë që nuk kishte as ndryshimin më t'imtë prej sendeve naturale, me terma të shkurtëra, si një plaçkë. Ajo shiteshte dhe bleheshte në tregje si shiten dhe blehen sendet e tjera, aty nuk i epesh as më e vogëla vleftë. Athinasit nuk patën mjaftuar me kaqë por e patën konsideruar atë si një gjë të ndytë prej punëve të djallit; ata e patën ndaluar atë të merresh me punë çdo lloje veçse me rregullimin dhe edukimin e shtëpisë. Gjithashtu, duhet të shtojmë se Athinasit e patën lejuar martesën me më shumë se një grua ose me çdo numur grashë që dëshërojshin burrat. Këjo do të thotë se ata patën lejuar një polygamië të tmerrëshme dhe krejt n'ekstrem. Por nuk do t'u-mjaftonte me kaqë sikur t'a lemë më njanë Athinën dhe të këthehemi në Spartë, këtu me një herë do të gjejmë se me gjithëqë burrat u-përpoqën të përdorin interdiksionin a ndalimin më të math për t'u-martuar me më se një grua a më mirë të thomi për të përdorurit e ndonjë lloj polygamie, këjo nuk pat qenë lejuar veçse në raste të jashtë zakonëshme a të shtërnguarëshme. Por, nga ana

tjetër njëj gruaje i u-pat lejuar që të martoheshte, për një herë, me më se një burrë, këjo d. m. th. që gruaja përdoronte polyandrinë. Kështu më të shumtat e grave e patën ushtruar këtë zakon vicioz që s' është tjetër veçse një lloj dekadence që pat arrirë gjer në kulm të përtëjmë.

Polygamia, nga ana tjetër, nuk pat qenë përfshirë prej ligjit as në fillim t' Imperatorisë Romake as në fund të saj. Me gjithë këtë ajo ishte përhapur në të katra anët e saj d. m. th. në të gjitha vendet që sundoheshin prej saj. Dëshmitar më i math i kësaj është vetë Imperatori Valentinien i II, i cili pat urdhëruar se ishte e lejuar për të gjithë suzhet e tij të martohen me më se një grua po të dojshin. Por edhe historia nuk flet në ndo një vend që prisat fetarë të faltoreve t'a kenë përbuzur këtë tolerancë. Përkundrazi, të gjithë pasardhësit e Valentinienit patën ndjekur po gjurmën e tij. Polygamia pat vazhduar me këtë cilësi gjer në kohën e Justinianit. Justiniani, mandej, pat vënë ligjët e tij, të cilët ndalojshin polygaminë, me gjithë këtë, këto ligje nuk e patën ndaluar njerëzinë prej të pasuarit të këtij zakoni. Ajo çka tregojshin ligjët e tij nuk do t' ishte tjetër veçse një shfaqje nga ato të ndryshimit të mendimit të një tufë e pakët prej të mësuarvet. Por shumica e popullit nuk i u pat vënë veshin as që t'i kenë dhënë ndo një rëndësi të duhur atyne soj ligjësh, ata nuk patën gjetë, në tërësinë e tyre, ndonjë ndalim që të mund të pengonte zakonin, me të cilin ata ishin stërvitur. Shto edhe se kur popujt barbarë patën mundur e mbuluar Europën Perëndimore edhe opinionet a mendimet e tyre, prirjet dhe zakonet që ata kishin patën qënë përzier me ato të vendeve t' invazuara dhe t' okupuara, qenë përpjekur t'a ndalojnë polygaminë por nuk i patën shpëtuar kësaj. Si shkak për këtë është zakoni dhe stërvitja e kryetarëve të tyre me një të tillë polygamië si dhe toleranca e burrave të fesë për me i a lejuar njerëzisë, leje që e epte ndo njeni nga kryetarët e saj, të gjitha këto e patën shtyrë popullin të qendrojë mbi zakonin me të cilin ishte mësuar për t'a pasur.

Por edhe disa nga tufat e Judenjëve e patën numëruar vajzën si një shërbëtore, ajo u-shitëte prej atit të saj, çka më tepër ajo u-numuronte nga një herë minore dhe nga një herë e dobët; ajo nuk mundeshte të trashëgojë veçse atëherë kur i ati të mos kishte pllaz meshkuj.

Te disa nga arabët e injorancës, gruaja pat arrirë në një dekadencë të madhe. Te këta, zakonet e shteteve kufizore patën lënë përshtypjen e tyre më të thellë, aqë sa arabët qenë stërvitur t'a numurojnë gruanë si një pjesë të pa ndarshme të pasurisë s'atit ose të burrit të saj, dhe gratë e veja patën arrirë të konsidroehen si trashëgim i djalit ose i vajzës së gjetur; ky ves pat përshkuar dhe dëpërtuar gjer në fiset e Jemenit, të cilat përbëheshin prej Judenjëve dhe prej Sabiinëve (Sabianism ose Sabeism: doktrinë e atyre që i faleshin trupave qiellorë).

Shkurt, vendi i gruasë pat qenë fort i ulët në shoqërinë njerëzore, në ditët e Imperatorisë Persiane dhe Bizantine, fanatizma e pat poshtëruar tepër; e pat konsideruar se gjoja është shkaktuësja e të keqes dhe e mjerimit, dyke harruar se e keqëja dhe mjerimi që i mbështeten asaj, nuk vinte veçse prej rrokullisjes dhe dekadencës së shoqërisë së atëherëshme gjer në lucën e veseve; por në këtë kohë zëri u-çua nga çdo anë. Provat e shumëta e vërtetuanë se të gjitha institucionet dhe ligjet e vjetëra ishin të pa përshtatëshme ose të korrupsueme. Gruaja vazhdoi kështu duke u-marrë nëpër këmbë e drejta e saj, duke u-shtypur nënë barrën tiranizuese dhe duke mos i dhënë as më të voglën rendësië problemës së saj gjer sa i a shkarkoi prej supevet të saj këtë vuajtje Ligji i lartë i Islamit sepse në këtë kohë pat dalë në dritë Shpëtimtari i Gruasë, Profiti i Math Arab (Paqi dhe Shpëtimi i Zotit mbi Té) me një Libër-Bujar që thotë: «ato gëzojnë atë të drejtë që i u përket me të mirë, po kështu edhe burrat përmbi to gëzojnë një llojgrade»⁽¹⁾. Këto gjurmë ndoqën edhe pasuësit e Profitit Bujar duke nderuar gruanë dhe duke i lëshuar asaj vëndin e duhur që i përket. Kështu Aisheja pat qenë emëruar Zonja e grave të Parajsit. Me këtë në argumentojmë se Ajo ishte një ideal i gruasë së përsosun: në mirësië, në nder, në virtut, në divotshmenië dhe në diturië. Po kështu erdhën mbas saj shumë gra muslimane që ëndën të njëjtën ëndje, duke ecë nënë hijen e saj, që morrën pjesë aktive në fjalët dhe në veprimet e saj; gra që fituanë në gjirin e diturisë, të virtutit dhe të nderit vëndin që i u përshtatej, vëndin e lartë të famës.

Disa nga kundërshtarët e Fësë Islame i shumuanë akuzat

(1) = We lehunne mithlu-l-ledhî alejhinne bi-l-mârufi, we li-Brixhali alejhinne derexhé.

duke kujtuar se këjo Fé i ka grabitë gruasë të drejtën dhe e ka ulur në një shkallë më t'ulët se shkalla e vërtetë që i përshtatet, duke kujtuar se këjo Fé ka qenë një e keqe dhe një kalamitet i math, një lopatë përmbysëse e konstruktit të Shoqërise njerëzore. Këta sikur të vërrejshin me synë e mjaftimit në Librin e Të Madhit Zot, në Traditën Profetike, në Sjelljet e të Mirëvet të parë, do të kishin shpejtuar të pohojnë se Ligji toleruës i Islamit e mjaftoi gruanë dhe e çoi a e ngriti në një gradë fare të lartë, në një kohë që në Çinë ishte e burgosur, në Perësië i kishte rënë vlefta, në Egjyptë ishte poshtëruar dhe në Europë konsiderohesh një me sendet që pasurohen dhe së fundi në vendet arabe një send për t'u trashëguar.

Një herë në Francë qenë mbledhur dhe patën kërkuar e biseduar se a numurohet gruaja njeri a po jo? Përfundimi i bisedës dhe i kërkimit që se ajo ishte një njeri porse ishte krijuar t'i shërbejë burrit!

Si përfundim mund të themi se Profiti i Islamit (Paqi i Zotit dhe Shpëtimi i Tij mbi Të), që dërguar në një kohë që të kallurit e vajzavet në dhë të gjalla, ishte një zakon i disa fiseve. Gjer atëhere nuk që njohur në as një vend ndonjë institucion që t'i epte gruasë si dhe t'i njihte asaj ndonjë prej të drejtavet që duhej të gëzonte, qoftë vajzë ose grua ose nënë. Ai, erdhi së bashku me një Ligjë, që i njeh gruasë të drejta dhe detyra si ato të burrit e që disa nga këto të drejta dhe detyra nuk i a patën njohur vendet e Oksidentit veçse aty kah qindvjetëshi i XIX-të, mbas luftash dhe përpjekjesh t'ashpëra.

(Vazhdon)

DR. B. SHAPATI
K. i K. M.



Ç' vend zën Kur'ani në pikpamje Legjislasoni?

(Vazhdon prej Nr. 2)

PRA, gjykatësit e arabëvet, tek të cilët njerëzit gjykoheshin e ndajshin gjyqet e tyne, janë të njohun; për këtë, në një mënyrë të qartë, dëshmon edhe poezia e tyne. Edhe vetë historianët kanë biseduë dhe kanë dhanë mendimet e tyne për mbi këtë pikë. Porse duhet të dihet që këto forma gjykimesh, që të gjitha, kur t'analizohen mirë, nuk mundemi me gjetë ndër 'to as një parim të ngulët, dhe as një rregull të njohun. Shpesh herë ndodhte dhe u-shfaqte ndonjë prej problemave që u-gjykonte mbi té; mandej, e njajta problemë u-shfaqte në një ditë tjetër dhe u-jepte mbi té një gjykim tjetër i ndryshëm prej të parit. Shumë herë, gjykimi ndryshonte simbas qarqevet dhe konditavet shoqënore si edhe simbas individualëvet të cilët u-gjykojshin. U-vepronte kështu sepse, sikur e përmend këtë edhe i ndjeri Her Von Rat, nuk kishte ndonjë parim të ngulun. Arabët nuk qenë përpjekë as pak për me shënuë ose me rregjistruë ndonjë parim të tillë që të mundeshte me u-marrun si parim kryesuër. Ata as që patën vërtetuë ndonjë prej këtyne parimevet për t'i konsideruë si bazë. Shto edhe se aty nuk u-njihte tjetër bazë veç konvensionit (Urf), një konvesion që hynte në punë për sa u-përket adhurimeve dhe veprimeve të tyne. Ata kishin qysh atëhere një lloj adhurimi që asht të munduëmit me u-afruë te Perëndia si p. sh. vizita që i bajshin Shtëpisë së Shénjtë⁽¹⁾ dhe Taksa⁽²⁾. Gjithashtu kishin përdorime të veçanta në tregëti, në shitje e blerje si edhe në të marrunit e në të fituëmit e ndonjë pjese prej fitimit që vinte prej punës që u kryesonte prej ndonjë njeriu të veçantë.

Tashti le të përfundojmë tue vendosë që Islami nuk erdhi për me pasuë jetën injorante të kohës pré-Islamike në të gjitha fazat

¹⁾ Vizita në Shtëpinë e Shénjtë: Haxhah.

²⁾ Taksa: Zeqat.

e saj si edhe në gjendjen e saj të çalë. Me gjithë këtë Ai pohoi disa veprime të cilat pasoheshin prej tyne. Gjithashtu, shifet çiltazi që ligji islam përparoi dhe evolusionoi së bashku me këta njerëz. Ai, përsa i përket disa zakoneve dhe traditave të tyne, zuni vendin e një komshiu a ma mirë u-shoqënuë me 'ta. Me këtë rast duhet përmendun randësia e abrogimit dhe e revokimit (Nes-h'). Nes-h d. m. th. abrogi n i një ligji për me u-zavendësuë me nje tjetër. Ja një shëmbëll për këtë: Profiti (A. S.) e pat ndaluë një herë vizitën që i u bahet vorrevet dhe mandej e pat lejuë përsëri. Ai, herën e parë, i u pat lëshuë njerëzvet frénat në disa problema dhe mandej e pat kufizuë këtë lloj liriye pak nga pak. Dhe këtë veprim e pat ba vetëm për t'i nxitë njerëzit që t'i adaptohen e t'i shtrohen përpari mit gradual dhe për me i shtyë që të mësohen me traditat e reja. Ndofta ligji i përparimit gradual dhe preceptet e tij janë një shtyës a një shkak kryesuer që të trembëdhjetë vjetët që H. Muhamedi kaloi në Mekë nuk ishin veçse vite këshillash, thirrjesh dhe ftesash ma tepër se t'ishin vite detyrimesh (obligation)¹, impozimesh dhe ngarkesash, me fjalë të tjera vite urdhënash dhe ndalesash. Dhe ja, në të vërtetë, muslimanët nuk ishin urdhënuë ende për me kryë të Lutunit (Salat) gjer para Hexhircës dy ose tre vjet. Gjithashtu këto obligime të cilat do të baheshin ma vonë shtyllat kryesore t'islamit nuk qenë ba që të gjitha, për një herë, detyra të domosdoshme për muslimanët. Përkundrazi, ata u-detyruën me u-falun ma parë dhe mbassi qenë familiarizuë e mësuë me té si edhe mbassi qenë qetësuë shpirtënat e tyne, u-detyruën me një detyrë tjetër që asht taksa e domosdoshme (Zeqat), mandej me agjënim dhe ma në fund vizita e Shtëpisë së Shénjtë. Konstatohet se versetet e zbrituna në Mekë kanë të bajnë me Besim (Akidé), ndërsa ata që u-zbritën në Medine janë në marrëdhënëje të ngushtë me legjislacionin si dhe me veprimet e detajet që mund të rrjedhin prej këtyne veprimevet. Ky përparim gradual vërehet gjithashtu edhe në ecëjen e vetë legjislacionit. P sh. një detyrë ose një obligation për të parën herë filloheshte me një formë të zvogëluëme, mandej zgjanoheshin ma tepër në té. H. Muhammedi erdhi dhe ishte dhe Ai një njeri si të tjerët që hanë dhe pinë dhe

2) Detyrë: Ferida; Obligation: Vaxhib.

kanë përdorime në mes të njani tjetrit. Prandaj, nuk mund të shpëtoheshte për pa i marrë parasyshë dhe nxjerrë në dukë gjendjet dhe veprimet e tyre. Pra, për çdo gja që ishte e drejtë, jepte pëlqimin dhe çdo send të shtrembër e zavendësonte me atë të përshtatshmin. Ai eci Vetë mbi këto parime edhe para Islamit. Ai u-merrte me tregëti, bashkëpunonte me të tjerë në punë të ndershme. Ai jetonte mbrendë qarkut dhe atmosferës së jetës arabe, ishte thelluë në të, ishte në marrëdhanëje të ngushtë me të gjitha shfaqëjet e ndryshme të saj, me ato shfaqëje që konsideroheshin të përshtatëshme dhe të ndershme. Asht për t'u-përmendë se Ai nuk pat marrë kurrë pjesë ndër mbledhje korruptuëse. Ai gjithëmonë pat qenë shëmbëll i moralit të pastër; prandaj ishte e domosdoshme me ruajtë diçka prej shénjavet dhe mbeturinave t'asaj jete në shpirtin e Tij të Math. Tue u-mbështetë në këtë thezë, Islami nuk i këputi marrëdhanëjet e Tij me të gjitha gjanat që egzistojshin në kohën pré-islamike. Po, Ai i këputi, në një mënyrë absolute, të gjitha marrëdhanëjet e Tij me të gjitha besimet e korruptuëme, Ai jo vetëm që sulmoi por dhe shëmbi të gjitha ato gjana që shkaktojnë faje dhe mëkate.

Nga ana tjetër, Islami nuk i sulmoi as pak disa zakone dhe mësimet të mira: detyra e vizitës që i bahet Shtëpisë së Shénjtë ishte një prej atyne zakoneve të jetës pré-islamike që ma vonë e pat pranue edhe islami. Arabët e kryjshin vizitën kundrejt Shtëpisë së Shénjtë edhe përpara Islamit. Ky ishte një nga zakonet e tyre të mira. Islami nuk e ndryshoi essencën e këtij zakoni, Ai nuk veprooi ndryshe veçse e rregulloi, e gdhendi dhe e skalisi ma mirë këtë zakon.

Në mundemi për me e pasuë legjislacionin Islam në të gjitha anët e tij tue derdhë mundin me shfaqë, me provue e me demonstruë pjesën e ré që na ep ai, nga një anë, nga ana tjetër, tue shfaqë pjesën që i përket jetës pré-islamike. Shumë studjoza u-munduenë për me e shfaqë në një mënyrë të qartë këtë pikë, shkurt, me e garuë. Islami nuk refuzoi absolutisht të gjitha traditat dhe zakonet që kishin të bajnë me veprimet e jetës së injorancës. Po si mund t'i refuzonte disa prej tyre në rast që ato qendrojnë mbi baza të qarta dhe mbi parime të shëndosha. Kur erdhi H. Muhammedi, i Cili asht Legjislator,

Gjykatës, shfaqës zyrtar i ligjit fetar, Gjykuës i Urtë dhe egzekutës i hollë, shokët e Tij me ngulm shpejtuën te Ai tue kërkuë opinionin e Tij në çdo gja që iu ndodhte në raste të ndryshme. Dhe sa herë që t'a pyetshin përmbi ndonjë problemë ishte Ai vetë që u-përgjegjte po t'a dinte. Ai e urrente egoismin dhe nuk shmangesh as pak për pa lypë edhe opinionin a mentimin dhe njohuni të tjera prej atyne që i zotnojshin këto. Po t' ishte se edhe këta njerëz, që i shëmbëllejné një plebishiti të sotshëm të kohës moderne, nuk mundeshin me u-përgjegjë, Ai, tue dëshëruë mos me vepruë kurrë shtrembët e vononte çeshtjen tue pritë Revelatën që i vinte prej anës së Zotit të Math. Të mbështetunit e H. Muhammedit mbi shokët e tij si edhe t'adop-tuëmit e këtyne mentimin e Tij, asht një argument krejt i qartë që provon se Ai nuk kishte qëllim, me anë të legjislacionit, t'u imponojë a t'u ngarkojë njerëzve disa urdhëna që ata nuk do të kishin fuqi me i kryë. Përkundrazi, Ai u impononte ato urdhëna, me të cilat ishin familiarizuë dhe kishin një kohë të gjatë që po veprojshin tue u-mbështetë mbi to. Me gjithë këtë ngjarjet që atyne i u shfaqeshin, sa do të shumta që t'ishin, prap se prap ishin të kufizuëme. Të kufizueme, për shkak se jeta arabe e atëherëshme ishte e thjeshtë dhe as pak e komplikuëme, ajo nuk ishte një jetë shumë ngjyrash a e shumë llojëshme që t'i shëmbëllemente kësaj t'onës moderne në të cilën né jetojmë. Të gjitha ngjarjet dhe shfaqëjet e saj, me një fjalë ishin të kufizuëme. Gjithashtu, gjatë qëndrimit dhe jetës së Tij në Mekë, për sa i përket legjislacionit, nuk patën ndodhë ngjarje që mund t'u jepeshte randësia e duhun. Por këjo jetë nuk vazhdoi shumë. Kur erdhi në Medine filloi lufta dhe shkelja (invasion) si dhe plaçkat e mbetura prej luftës⁽⁴⁾ u-shtuënë. Ishte e domosdoshme të ndamit e këtyne plaçkave, por edhe këjo, simbas një plani të vizuëm prej Revelatës a Zbulimit që Atij i zbuloheshte. Në rasë se nuk i zbriste një plan si ky, Ai vepronte dhe gjykonte me ndonjë opinion të veçante që i vinte ndër mend. Mandej fliste tradisionin që kishte lidhje me këtë çeshtje. Ky tradision u-merrte si një argument përsa i përkiste këtij gjykimi të bamun e të dhanun. Por në rasë që Ai nuk mundeshte me dhanë mejtimin dhe opinionin e Tij, atëherë kërkonte mejtimin e shokëve të Tij. A nuk do t'i përngjante

(4) Plaçkat e mbetura prej luftës: ganaim.

edhe ky veprim jetës s'onë moderne!? N'atë kohë nuk kishte veprime të komplikueme si ata të sotshmit: pengu (rehen), huaja për një kohë të gjatë dhe huaja para afatit që kanë të bajnë me pikpamje të gjana të legjislacionit e që i gjejmë në jetën t'onë të bashkëkohëshme nuk ndodheshin atëhere një soj me formën që kanë marrë sot. Profiti kur çonte ndonjë dërguës me mission, ndonjë gjykatës ose ndonjë sunduës në ndonjë vend, e këshillonte me këshilla të domosdoshme për me e kryë këtë detyrë në një mënyrë të përsosun. Ai, gjithënjë përpqeshte që t'a lente këtë gjykatës ose sunduës të lirë në veprimin dhe në mendimin e tij. Dhe ja një shëmbëll e mirë që vërteton këtë thanëje: Ai, kur e dërgoi Muadhin në Jemen e pyeti në këtë mënyrë: O Muadh! me çka do të gjykoni? Muadh i u-përgjegj: me Librin e Zotit! Mandej? Muadh i, prap u-përgjegj: me tradisionin (Hadithin) Profetik! Së fundi? Muadh i, përsëri: me mentimin dhe opinionin t'im. Profiti i Madh u-kënaq shumë prej këtyne përgjegjeve, e bekoj Muadhin për këtë plan të mençëm dhe të kënaqshëm me të cilin do të vepronte.

Kështu, Profiti (A. S.), nuk mund të konsiderohet kurrësesi egoist në mentimin e Tij që shfaqëte kundrejt shokëvet dhe ndihmëtarëvet të Tij besnikë. Përkundrazi, Ai i lente edhe ata të lirë për me shfaqë mentimin e tyre, aq sa disa prej tyre kishin mejtime dhe opinione të veçanta që duhet t'i u jepet randësia e duhur për sa i u përket këtyne problemave. Qysh prej asaj kohe, disa ndër ta janë të njohun për gjykime dhe idë të drejta që delshin prej tyre. Dhe ja një shëmbëll kryesore: H. Umeri (Kënaqësia e Zotit qoftë mbi Té) asht një prej atyne gjykatësve prej nature (Fitri). Gjithë çka thamë. në tanësinë e saj dhe veç e veç, për sa i përket mësimëvet të LIBRIT, të Tradisionit, të gjykimit Profetik, t'opinionevet të shokëvet dhe të ndihmëtarëvet të Profitit, t'atyne që e rrethojshin dhe që ishin të bashkë kohshëm me Té, të gjitha këto duhet të konsiderohen si shtylla e legjislacionit Islam.

Por, duhet të dihet se arabët nuk qendruën mbrendë kufive të Siujdhezës së tyre, porse i kapërxyën këto tue mbërri në vende të tjera, tue ardhë në përpjekje me qytetni dhe përparime të ndryshme. Qëndrimi i tyre kundrejt këtyne qytetnive dhe përparimeve asht një qëndrim që i përngjan atij të një burri të thjeshtë e primitif, i cili nuk kupton as gjë prej sendeve që e rrethojnë. Këjo thjeshtësi primitive të cilën e gjejmë te beduinët nuk vazhdoi ma gjatë, por u-këthyë në një jetë të

ré. Këjo e treti jetën e ré, la përshtypjen e saj mbi té dhe së fundi u-përzi me të. Në këtë jetë të ré, në të cilën hyni populli arab, gjenden problema të reja që u-pa e domosdoshme për t'u zbërthyë. Në këtë periodë konstatojmë që legjislacioni Islam po evolusionon shumë shpejt, evolusionizëm këjo që ndoshta nuk i shëmbëllen as pak ndonjë tjetër e legjislacioneve të tjera historike. Një evolusion si ky nuk asht as pak i çuditshëm sepse asht evolusion i ngadhënimit Islam, ngadhënim i cili eci me hapa aq të shpejta që nuk i përngjan këtij as një ngadhënim tjetër. Dominionet e tij shtriheshin tue filluë prej thellësinave t'afrikës, nga ana e Perëndimit, gjer në thellësinat e Azisë, nga ana e Lindjes; tue filluë prej malevet Pirenenj nga Veriu, gjer në Oqeanin e Hindit. nga Juga; ngadhënim që u-plo-tësuë qysh prej vitit 8-9 të Hexhirës e gjer në vitin 70-72 të Hexhirës. Këtë ngadhënim të çuditshëm e pasoi një kompozim i math në mes t'arabëve dhe të popujvet të vendeve të tjera Ky la shënjat dhe mbeturinat e tij që nuk mund të mohohen. Arabët u-gjendën ballë për ballë me qytetnina të ndryshme, ballë për ballë me një institucion (nizam) gjykuës dhe legjislatif të veçantë. Prandaj, ishte një gja që u-shfaqëte e domosdoshme të marrunit e këtyne institusioneve në konsideratë. Ata u-përpoqën për me formuë dhe trajtuë për vet vehte një legjislacion Islam të veçantë që i ka bazat e tij kryesore në LIBRIN E ZOTIT.

(Vazhdon)

SADIK BEGA

PROBLEMI FETAR DHE FILOZOFIJA

Kur njeriu interesohet për me marrë vesh realitetin e ek-sistencës, një problem shumë i randësishëm i paraqitet përpara, problem që ka preokupuar mëndjet e gjith njerzëvet, qysh në kohën që kanë fillue me gjykue. Ky problem për-mblidhet në pyetjen: si dhe në ç'mënyrë u krijue kjo botë? Me fjalë të tjera si u shfaq dhe si mundi t'eksistojë kjo botë?

Po t'i hedhim një vështrim zhvillimit menduer të njer-zimit, do të konstatojmë se, qysh në kohët e lashta, njeriu, jo

vetëm ay me një zhvillim menduer pak a shumë t' arrirë, por edhe ay, të cilit nuk i ishte zhvillue ende kjo fuqi dominuese, ka mundur me kuptue se në këtë botë ekziston një unitet apo njisi në të cilën marrin pjesë të gjitha sendet e ndryshme të kësaj bote, d. m. th. se kjo botë, përgjithësisht, asht si një gja e vetme, pjesët e së cilës, si ato që shifen, po ashtu edhe ato që syri i njeriut nuk ka mundur me i përshkrue, lidhen ngushtë njana me tjetrën. Gjithashtu, njeriu, me anë të zhvillimit gradual të mendjes së tij, mundi të kuptojë se të gjitha fenomenet e natyrës i shtrohen një rregulli dhe harmonije të mrekullueshme dhe se këto fenomene nuk mund t' i shtëmangen ligjevet të paracaktuara për funksionimin e mirë të tyre. Këtu nuk mund të zgjatem mbi problemin e determinizmit shkencuër, mbasi një gja e tillë e largon këndonjësin prej sybjektit, mbi të cilin jemi tue folë. Qëllimi i ynë asht që t' i hedhim një vështrim të shkurtër gjith periudhavit të ndryshme për të konstatuar se ç' farë kujdesi dhe ç' farë roli të randësishëm ka luëjt problemi fetar gjatë këtyre epokavet.

Po të hapim faqet e historisë së Filozofisë si edhe ato të Metafizikës, do të konstatojmë se të gjith ata që janë marrë me zbërthimin e problemavet, filozofike janë të një mendimi se njerzimi, në të gjith' epokat e ndryshme, qysh prej ditvet të foshnjërisë dhe deri në shekujt e zhvillimit dhe të përparimit të tij, ka pasur bindje të plotë se ç' do gja për rreth tij, si loka që e mban dhe qielli q' e qarkon, vepron simbas një ligji dhe harmonije të mrekullueshme. Tue konstatue harmoninë e natyrës dhe rregullin e fenomenevet fizikë, një presjon i natyrës dhe, njëkohësisht, një dëshirë për të kuptue realitetin e eksistencës, e shtytën njerinë për me pyetë e me marrë vesh se cili asht faktori i kësaj harmonije dhe si mundi t' ekzistojë?

Të tilla pyetje, që formojnë bazën e filozofisë dhe të Metafizikës dhe që, njëkohësisht, i kanë dhënë hovë zhvillimit të mapastajshëm të shumë shkencavet, kanë marrë përgjegje të ndryshme, natyrisht, si mbas fuqisë mendore dhe kulturele f' atij që mendohej me i arrijt fatit të lumtur të zbërthimit të këtyre enigmavet të natyrës. Jo vetëm kaq, por edhe tendenca psikologjike si edhe rryma e shekujvet kanë dhanë kontributin e tyre në të tilla gjykime dhe analiza. Tue marrë në shqyrtim mendimet e filozofvet të parë të Greqisë, konstatojmë se ata kujtonin se e kanë zbërthye këtë problemë kaq të randësishëm,

tue shprehë se ekziston një bazë e vetme, nga e cila kanë burue të gjitha sendet e natyrës. Për Thales-in ky element i vaçantë ishte uji, për Anaximandre-in pafundësija, për Anaximene-in ajri dhe për Heraclite-in zjarri. Këta fizicien të parë të Greqisë mendojshin se ekzistenca e çdo gjaje në këtë botë mund të përfitohet vetëm prej këtij burimi. Por një studim i imtë i problemit në fjalë na jep të kuptojmë se këta gjykues të parë nuk i janë afrue as pak zbërthimit të këtij problemi, mbasi, këtu, nuk asht çështja në se sendet përbahen prej një ose më shumë elementash, por si munda të ekzistojë kjo botë prej kaosit dhe cili asht faktori që hartojë planin e mrekullueshëm të kësaj natyre të pafund? Në dasht, pra, sendet e natyrës të jenë të përbame prej një ase më shumë elementesh, ajo që duhet të nxjerrim prej kësaj shprehje, si një konkluzion i vërtetë, asht fakti se për ekzistencën e këtij elementi ase të këtyre elementeve duhet të ndodhet një shkak preponderent, që ka ushtruar fuqinë e tij dhe ka krijuar gjithësinë.

Por ky shkak i ekzistencës asht kuptue dhe interpretue në mënyra të ndryshme, gja që i ka dhanë shkak të dukunit të disa doktrina vet filozofike, si atomismi, theismi, racionalismi dhe pantheismi.

Doktrina e filozofvet atomistë, si Heracliti dhe Democriti beson se ky unitet, që shifet në natyrë, nuk asht tjetër veç se një dukje q' i shfaqet syrit të njeriut, por e vërteta asht se një numër i pafund atomeesh ndodhet në natyrë, të cilat lëvizin pa ndonjë qëllim të caktuar: disa herë bashkohen me njana tjetrën dhe herë të tjera ndahen dhe marrin drejtime të ndryshme. Pika më atheiste e kësaj doktrine qëndron në idenë se bashkimi ose ndarja e këtyre atomevet nuk asht vepra e ndonjë shkakut të mbinatyrshëm, por efekti i lëvizjes së përkohshme, e cila, edhe kjo, asht një pjesë e realitetit të tyre.

Natyrisht, një shpiegim kaq i thjeshtë dhe i sipërfaqshëm nuk e kënaq njerinë për shumë kohë, mbasi ai e ka në natyrë që të pyes për të kuptuar shkakun kryesues të këtyre fenomenevet. Prandaj një teori tjetër më e plotë, Theismi, vjen dhe plotëson mungesën e së parës. Të gjitha ndjenjat e mbrendëshme të njeriut, sidomos ajo që parasheh nevojën e mbështetjes mbi një fuqi, ajo që dikton nevojën për mbrojtje, të gjitha këto e shtytën njerinë me besue në ekzistencën e një Fuqije të naltë, e padukshme ndaj syrit; Fuqi që zotnon një

vullnet të pakundrështueshëm. Kjo fuqi, pra, asht Shkak i kësaj natyre dhe i harmonisë së saj: kjo Fuqi asht misteri i çdo gjaje dhe se njeriu gjen në 'Të faktorin e ndihmës dhe të lumtërisë së tij. Edhe kaosi i përmendur prej disa filozofëve atomistë duhet të ketë një rregullues që mbikqyr punët e tij. Asht shumë tipike pyetja që i bëri Epicure-i mësuesit të tij, filozofit Xenocrate, i cili shpiegonte se bota u krijua prej kaosit, Epicure-i ia priti: po kaosi si mundi t'eksistojë? Simbas doktrinës së Theizmit, kjo Fuqi rregulluese asht shkaku kryesues i eksistencës së gjithësisë; ajo asht çelësi, me anën e të cilit zbërthehen enigmat ma të vështira dhe vetëm kjo Fuqi na e shpiegon mirë e qartë qëllimin e kësaj bote. Max Muller-i thotë: «të vërtetë e fenomeneve të natyrës e udhëheq njerinë me kuptue një Krijues mbrapa këtyne fenomeneve». Të tilla nxitje po me këtë përmbajtje janë të panumërta në Librin e shenjtë t' Islamit.

Edhe më parë se të lindte dielli i qytetnimit, njerzit e kanë pohue eksistencën e Zotit, aq sa në çdo popull dhe në çdo shekull e kanë quejtë me një emër të veçantë, si mbas rrymës së shekullit. Jo vetëm qielli, por çdo kreatyrë asht një argument i randësishëm dhe i mjaftueshëm për vërtetimin e nadhërisë së Tij. Poeti angles, Tennyson, thotë: «Jo, nuk janë Dielli, Hana, yjet, fushat dhe lëndinat veç se një nga pamjet e Zotit të të gjithë botnavet».

Besimi ndaj Zotin asht i rrënjosur në shpirtin e njeriut, buron herë pas here, sa edhe në shpirtrat më të sterruarë. Ideja e besimit në Zotin ka qënë n' e parë një ide e thjeshtë, ide që përqëndrohej n' egoizëm dhe në dashuri të vetvetes, por me kalim kohe ajo arrijti të bëhej një fushë e gjanë e teorivët të ndryshme dhe e idevet të kundërta. Në popujt e paqytetnuem, kjo ishte një ide q' e konkretizonte Krijuesin në forma të ndryshme, por, ma vonë, kur drita hyjnore filloi t' a ndriçonte edhe më tepër mendjen e njeriut, kjo u bë një ide krejt e vërtetë dhe reale, e pranuar prej filozofëve më të mëdhenj të botës, si Hegel, Renan, Voltaire, Max-Muller dhe të tjerë,

Mbasi jemi tue shqyrtue këtë problem, nuk mundemi me u kufizue vetëm me kaq për me vërtetue realitetin fetar, por do të sjellim edhe disa fakte të tjera, tue u mbështet në shkri-me të filozofit angles, Herbert Spencer, i cili thotë: «Po të he-

dhim një vështrim mbi historinë e popujvet të kaluëm, mbasandaj t'a këthejmë vështrimin t'onë mbi qytetnimin e popujvet të tanishëm, do të shofim se nuk ka ndo një popull në botë, i vjetër ase i ri, në të cilin të mos kenë eksistue ase të mos eksistojnë besimet fetare, sa do që mund të ndryshojnë këto besime në pikpamje të llojit dhe të shkallës së lartësisimit të tyre. Një njeri i kuptueshëm a mund të besojë se të gjitha këto besime kanë eksistuar rastësisht?»

Spencer-i, i cili gëzon një autoritet filozofik të randësishtëm, asht krejt i qartë në shprehjen e tij dhe pa dyshim fjala e tij asht një dokument i vlefshëm për vërtetimin e realitetit fetar. Me gjithatë, do të mundohemi t'a analizojmë këtë shprehje, jo për të nxjerrë në dritë idetë dhe mendimet e vërtetuara dhe të pranuar prej të gjith atyre q' e shofin dritën e shkencës n' objektivitetin e saj, por për t'ja u lehtësue këtë barrë të gjith atyre që nuk janë marrë me të tilla vërtetësina, për veç se me ndonjë romancë tërheqës të ndonjë fantazije mashtruese.

Jo vetëm si mbas Spencer-it, por edhe si mbas të gjith filozofëvet theistë ndjesitë fetare dhe tendenca për të gjetur Krijusin e gjithësisë kanë eksistue qysh n' atë kohë që njeriu filloi me u orientue në natyrë. Kur se realiteti i fesë shtrihet kaq thellë n' epokat ma të lashta të kohës, pse vallë ndodhen disa fise njerzish t' egjër, në të cilët nuk eksiston as mendimi më fillimtar mbi Krijusin e rrozullimit? Ja pyetja, që preokupojnë mëndjet e disa kritikëvet të cilët kujtojnë se besimet u dukën vetëm atëhere, kur njeriu kishte arrijtur në një shkallë të konsiderueshme të zhvillimit të tij menduer.

Një kritikë e tillë nuk e ndryshon as pak idenë e paraqitur më naltë dhe ja sepse: po të pranohet, në parim, pjesa e dytë e kësaj kritike që mendimi për me besue në parimet fetare u shfaq për herën e parë vetëm n' ato fise, në të cilët gjëndja e tyre mendore kishte arrijtë pak a shumë një shkallë të zhvillimit të saj, atëhere prej kësaj del në dritë se të tilla mendime e besime lindin pa tjetër prej zhvillimit menduer. Po të marrim parasysh edhe evolusjonin që ka pësue mëndja e njeriut gjatë shekujvet të kaluëm, do të mundemi me kuptue më së miri misterin e fjalës së urtë se feja asht vetë mëndja dhe se nuk ka fe ay që s'ka mëndje. Ndryshimi q' eksiston në mes të besimevet na ndihmon në vërtetimin e këtij përfundimi, sepse ky ndryshim tregon qartazi se besimet e çdo po-

pulli kanë lindur krejt të lira e të pamvaruna nga ato të popujvet të tjerë dhe se gjëndja e shumë popujvë në rrethana të njëjta, me gjith ndryshimin e kohës dhe të vendit, ka dhënë si përfundim krijimin e disa mendimevet të njëjta dhe konkluzionevet të përgjashme.

Disa të tjerë duan të besojnë se mendimet dhe idetë fetare u shfaqën për herën e parë, mbasi u shpërndanë grupet njerzore në të katër anët e botës dhe se çdo fis, kur shpërngulej prej një vendi në një tjetër, shpinte me vehte dhe mendimet fetare. Por filologët e kohës moderne i përgënjeshtrojnë me fakte të gjitha këto pretendime dhe vërtetojnë me argumenta të pakontestueshme se shpërndarja e racës njerzore ka ndodhur në një kohë kur gjuhërat nuk kishin mërrijt deri në atë shkallë, sa të shprehëshin ndjesitë fetare. Me gjithatë, po qe se pranohet ky pretendim, sado që asht jashtë çdo realiteti, atëhere çka mund të thuhet për përgjasimin e parimevet fetare ndërmjet fevet të ndryshme? T' ishte feja një institucion pa baza të shëndosha në të gjitha fushat dhe aktivitetet e ndryshme të jetës, atëhere pse kritika shkencore, e cila ka rrëzue nga themelet një tok sypersticjonesh dhe besimesh të kota, nuk ka mundur, dhe nuk do të mundet, m' e rrëzue mendimin kryesuer, mbi të cilin janë bazue të gjitha fetë? Dhe për më tepër, t' ishte i vërtetë ky pretendim, pse ndjenjat fetare, mbasi çfuqizohen në një popull, sikur se ndodhi në Francë në fundin e shekullit të XVIII, nuk vonojnë të duken përsëri, në mos në formën e parë, të paktën në një formë tjetër më të përshtatun mentalitetit të kohës, por tue mbetur gjithnjë e patundëshme baza kryesore e saj?

Disa të tjerë kujtojnë se «besimet janë përfundimi i ndjenjavet fetare, të cilat e detyrojnë mendjen e njeriut të krijojë një tok forma të ndryshme imagjinatash, që, mbas disa kohe, marrin formën e gjanavet reale». Edhe këtu shifet qartazi se përkrahësit e këtij pretendimi e pohojnë eksistencën e ndjenjavet fetare, pse s' kanë se si t' a mohojnë, mbasi një gjë e tillë ndodhet në opinionin e përgjithshëm dhe se kjo ndjenjë ka qënë një nga shkakët e përparimit gjatë periudhaves të ndryshme të historisë. Sidoqoftë, ky pretendim e zhdruk një pjesë të vështirësisë së këtij problemi, sepse në dasht të jenë ndjenjat fetare ato që lindin nevojën për fe, ase ndjenjat dhe nevoja për fe janë të një burimi të vetëm, një pyetje e randësishme na del përpara: prej nga na ardhën këto ndjenja?

(Vazhdon)

PROF. VEXHI S. DEMIRAJ

BESNIKIJA SHOQNORE

PO DAL para jush, të dashtun Lexuesë, për me folë mbi një subjekt të rëndësishëm. Frigohem se s'kam qenë në gjendje t'a shpreh në një mënyrë të rrjedhëshme ashtu si lypset, por kjo është përpjekja e përvuejtun e njënit që don me ju diçka që ndoshta nuk keni njohuni të mjaftë.

Asht e vështirë me i zbulue thesaret e mëshefta të shoqënisë e të dashtunisë. Unë kam vetëm një shpirt simpatik për me ju dhënë një lloj ushqimi shpirtuer, i vlefshëm për të gjithë e pastaj është detyra e juej.

Me këto radhë due me ju kallzue se ç'ka don me thënë shoqëni a dashtuni. Ç'ka është ajo si një agjent e faktor në formimin e përbërjes e jetës s'uej? Prej nga buron ajo, ku banon dhe se ç' dhuratë ose bekim na sjellë ne të gjithëve? Do përpiqem t'a shpjegoj këtë themë me shembëlla kudo që të nevojitet.

Pra, "ka një ndryshim të math në mes të një të njoftuni e të një shoku. Asht detyra e jonë me qenë fisnikë e të sjellshëm kundrejt të gjithëve. Mund të kemi lidhje të kënaqëshme dashtunije dhe një këmbim marrë-dhënjesh bujare me shumë persona që nuk janë, me plot-kuptimin e fjalës, shokë" "Shok është ai, të cilit na i apim zemrën t'onë, kërkojmë shoqënimin e bashkë-punimin e tij. Atij i zbulojmë sekretet t'ona; nga opinionioni e këshillat e tija na jemi t'influencuem e të prekun. Shkurt, ai është një vehtë e dytë e jona, reciprokisht simpatizohemi dhe ndihmohemi" Këtë kam mundun t'a nxjerrë prej Librit të Mr Murdoch. Na jemi qenjë të logjikshme e të pajisuna përmbrënda nga një shpirt i pavdekshëm. Mohojeni atë në daçi, porse shpirti, në qoftë se ia përgjet ndonjë sendi, është i pavdekshëm. Ai ka burue nga i pambarueshmi e i pashëmëlllyeshmi. Po, një sendi ju s'mund t'i bini mohit, zaten s'mundeni me e rrefuzue, dhe ai është ndryshimi në mes të krijesave shtazore dhe të njeriut, pse ky i fundit ka diçka përmbrënda, queje atë mendje, shpirt ose arsye; diçka, them, që e bën atë t'afte për me kuptue, argumentue dhe shoshitë të vërtetën ashtu si është në natyrë. Por nuk është vetëm kjo fuqi që ushtrohet nga shpirti përmbrënda asaj bote të ftohët.

Ai mund të dashurojë dhe t'urrejë ka fuqi të zgjedhë ndonjë që t' a bashkojë me ju në lidhje shoqnore, e mund të rrefuzojë gjana të tjera nga altari i zemrës s'uej. Mësoni së pari të dini këto dy fakte mbi shpirtin t'uej. Ju mund të thoni: mirë po ka disa që as i duem as nuk i urrejmë, atëhere si punon shpirti i jonë kundrejt 'tyne? Po, por duhet dijtë se, si e thashë më sipër, shpirti ushtron fuqinë e rrefuzimit të disave nga një vend n' altarin e zemrës. Në qoftë se pajtoni me mue për sa kam thënë, ju s' do të gjeni ndonjë vështirësi në shpirtin t'uej tue qenë të pajosun me këtë fakultet, që është rrefuzimi i shumë vetve nga bashkimi n' atë gradë, e cila është rezervue vetëm për disa të pakë.

Dashtunija le të kuptohet zgjedhje. S' mund t' a mohoj që kur një i dashtun e cakton qëllimin e dashtunisë e të shoqënisë së tij, ai, në të vërtetë, bân një zgjedhje. Do t' ju flas se çka e përcakton këtë zgjedhje. Kjo i ka rrânjët drejt për së drejti në burimin e shpirtit t'uej, e kot do ju kallzojsha se kjo shoqëni rrjedhë nga shpirti i juej dhe nga krijuesi i saj, që është burimi kryesuer. Pra, atëhere dhe vetëm atëhere shpirti i juej me të vërtetë do të gëzohet, do të rritet e do të zgjânohet për me i lëshue më shumë vend dashtunisë së kreatyrave. Gjykojeni e sprovoheni në vet-vehte në se kjo s' është e vërtetë.

Prap le të shohim se ç' frute ep shoqëniya; le t' ia lemë Lord Bacon-nit të na udhë-heqë në numurimin e dobinave e të përfitimeve që mund të na sjellë ajo: "Fruti më i parë i shoqënisë është rahatija e shkarkimi i plotë i gufimeve të zemrës, që pasionet e çdo lloji i shkaktajnë e i shtyjnë. Fryti i dytë i shoqënisë është shëndeti dhe supremasia për me kup-tue. Mbas kësaj dy lloj frute fisnikije të shoqënisë janë, paqë në dashtuni dhe përkrahje gjykimi, të cilët i ndjek fruti i fundit, që është porsi shega plot me kokrra; due të them ndihma dhe përkrahja pjesore ndër të gjitha veprimet e rastet"

Atëhere shoqni, pik së pari, don të thotë kultivimi ose t' ushtruemit e fakultetit të zemrës ose të shpirtit. Kështu ajo është e veçantë vetëm për njerzit. Asht një privilegj dhurumun juve për me e kultivue tokën e papunueme e të djerrun të kësaj zemre të ngurrueme dhe të këtij shpirti të shëmtuem. Merrni dramcat e arta të shoqënisë porsi një prodhim pasunie. Krynie me shumë kujdes detyrën shoqnore. Në qoftë se ju s' keni shokë në këtë botë, s' është fatkeqsija e juej, por gabimi

t'uej. Në se do të kujdesohi t' i dashuroni të tjerët, ata do të bâhen shokë t' uej.

Në të zgjedhunit e shokëve ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm e të matun. Mos u-tërhiqni nga lakmitë ose imagjinatat që rrjedhin prej ndjenjave pjesore ose nga interesat private t' ueja. Shpesh flitet se shoku është veltja e dytë e jotja, dhe është e vërtetë se kurrkush s' ka një influencë aqë të madhe në formimin e jetës e të sjelljeve t' ueja sa shoku dhe miku i juej i ngushtë. Shokët ju shtojnë gëzimin tue marrë pjesë në hidhërimet t' ueja. Shokët ju ndihmojnë për me e kalue një vështirsi me këshillat, ndihmën ose përkrahjen e tyne. Ata me një mënyrë bujare ju korrigjojnë, ju qortojnë tue ju dftue edhe të metat e dobësitë t' ueja. Në të vërtetë, në se do të ketë në botë ndonjë fuqi, që të ketë një influencë direkte, është lidhja me të cilën jeni ngjitur e bashku ngushtë me shokun t' uej në shoqëni. Lumtënia e vërtetë s' gjindet në të pasunit shokë shumë, porse në vleftën e zgjedhjen e tyne.

Njeriu nuk mund të ketë veçse të pakë shokë të zgjedhun, e në qoftë se ndokush mburret me një listë emna shokësh, mburrja e tij është e kotë, ai akoma s' ka shokë. Kjo zemër mund të nxen vetëm pak, ajo s' është aqë e gjënë dhe e çelun sa ajo e Zotit, që i don të gjithë pa asnjë të metë. Në qoftë se them, jo nga zemra ose fisnikija e ime, porse si një fakt i pamohueshëm, që ju jeni shokët e mij, unë flas rrenën më të zezë. Me gjithatë unë kam urdhnat e dallueshme nga Ai që kontrollon e sundon gjithë botën për me e dashtë krejt njerzinë. Prap unë i lutem Atij të më pajosë me cilësitë e Tij. E vërtetë është në këtë anë të vorrit që na duhet të mjaftojmë me pasë një numur të kufizuem shokësh. Tash ju mund t' a realizoni se përgjâsimi në natyrë e në sjellje, shijimet e pjerrjet janë kryesore në shoqëni. Dhe se, a kujtoni që ky pajtim ndodhë aksidentalisht ndër të gjithë? Ju mund t' andrroni me i sjellë në rreth të pamoralshmit, që i kanë zgjidhë frenat e epsheve :

Porsi dallgët e Oqeanit që ndërrojnë,

Kështu ndjenjat e disave fluturojnë;

Dhe kush mundet t' a shtjerrë në krahmor

Atë që pasionet e veta si stuhi i korr!?

Pra, me që subjekti kërkon një studim të thellë e serioz, nuk po zgjatem. Due që t'i veni veshin një pike : A është ai që

Ju i dorëzohi dhe e dashuroni, shoku i vërtetë i jueji? Në qoftë se ai e ka ngreh ndërtesën e dobësisë së tij mbi rânë, ka parime të këqija dhe jetën morale të prishun; në se ai është tue shkue kundra qëllimit të vërtetë të tij, bâhuni të kujdesshëm, ju këshilloj, largohuni nga shoqënia e tij para se të jetë shumë vonë e para se ju të pendohi e të rrifni kryet me grushta. Asht fare pa rândsi në se ju humbni prej tij një mik të ngushtë e një shok argtues a shakaxhi i math. Prap, në se shoku i juej është përtac, i plogët, kokë-zbrazët e i lehtë nga mendja, lerëni atë të shohë punën e vet. Asht një fakt se gripi i vogël është një sëmundje ngjitse, kështu, ndoshta mâ tepër, është edhe një shok i ngathët e pa mend; dhe e dini fare mirë se ju s'mund t'a përballoni kollaj kohën e tashme, që është plot gjallëri, jetë dhe industri.

S'është lehtë me takue në një shok ose mik të mirë, aqë më sa është e mundun me gjetë në çdo send që shkëlqen ar. Në të zgjedhunit e shokëve kish me qenë e arsyeshme, e volitshme a e përshtatun për ju të zgjidhni prej atyne që janë në një gradë me ju në jetën shoqnore, sepse këta, para së gjithash, do të provohen të përshtatun të simpathizojnë me ju e t'iu apin qetsinë e dishrueme.

Tue përfundue këtë pjesë të subjektit le të cekim detyrat e shoqnisë. Detyra e domosdoshme që i detyrohi shokut është me e ndihmue atë kur të jetë nër hidhërime a vështirsina, ose kur ai është sëmurë, pse ju e dini se shoku në nevojë provohet. Ju mund t'i vini në ndihmë atij për me i a largue hidhërimet, me i a ngritë frigën dhe me i a paksue vujtjet. S'ka recetë mâ të mirë, për një të mjerë që vuen nga sëmundja, sesa vizita e juej shoqnore, e cila në zemrën e tij të vujejtun ka me qenë porsì vesa e mëngjezit mbi një tokë të thatë e të djegun për ujë. Zâni i juej i dashtun, ndihmë e gatshme, do të veprojë mjaft si një bar i mirë tek shoku i juej i dëshpruem. Në qoftë se ngel në klasë ose dështon në ndonjë punë, biseda e juej kurajuese e simpathizuese ka me i ngjallë atij me një herë ndjenjat e zellit për një përpjekje të dytë. Në se është no- një send mâ i keq, si me thënë pendimi nga një faj që shoku i juej ka bâ, dhe ju në se jeni një dhuratë nga Zoti, keni me e udbëheqë atë në vendin e vërtetë të tultjes e të sigurimit. T'a këshilloni atë të heqë dorë nga jeta e tij e kalueme e të fluturojë ndër krahët e hapuna të

juej plot dashtun. Të lumtun janë ata që kanë gjetë një shok për kokë, që beson në të Vërtetën e Përgjithmonshme, pse këti nuk i mungon kurgjâ, dhe se e gjeni atë një këshilltar vërtet të mençëm e një shok besnik. Po ju pyes, më falni se po dal jashta themës, a e keni gjetun no një herë shokun apo mikun besnik, të vërtetë e të pandryshueshëm? Ah! Kjo është dëshira e zjarrit dhe e pafikut e atij që ju adresohet. Ju mund t'a dini që nuk ka lumtëni të vërtetë në këte shkretinë, përveçse në shoqënim me shokun e shokve ose mikun e miqve që është Zoti i Amshuem e i Plotdashtun. Së pari bëjeni atë shokun e mikun t'uej e pastaj Ai ka për t'ju zgjedhë shokët t'uej të tokës. Ju a them këtë i mbështetun n'eksperiencën e njerzve të mirë.

Detyra e dytë e jueja kundrejt shokut është, me e qortue atë gjithashtu që bân ndonjë gabim; por mbani mend fjalët qortuese që duhet të dalin nga një zemër gentile e të mirë. të zhytun në detin e dashtunisë. Po, por ndokush mund të thotë, se si mundet t'a njohim atë se është bujar në mënyrën e tij qortuese, kurse ai ka një natyrë t'ashpër e idhnake? Njeriu kur lindet është i pastër dhe sjelljet e mira ose ashpërsitë i fiton mbasandej. Ai, në qoftë se don me i frenue pasionet e tija të zjarra, e t'a edukojë vehten për me u-bâ gentil e dashurues, duhet t'i ndigjojë këshillat e shoqnisë. Dhe për në se dëshëron t'i mësohet përvújtnija e bujarija, ai s' duhet t'i rrefuzojë udhëzimet që i epen prej shokve drejt rrugës së vërtetë.

Shoqënitë, ku pasionet shpërthejnë në sarkazma dhe immoralitet, përbajnë zjarmin e math djegës për çdo individual të saj. Se i cili prej tyre rritet në mes të një tufe t'egrish e në vend që të bâhet i vlefshëm e bujar kundrejt shokut të tij, ai sigurisht ka me qenë një zotni detyrë krejt i pakënaqun e i ashpër, Cooper-i thotë:

Një që me emën e mbiemën ju saluton,

E nga mbrapa të nândëdheta ju punon;

Pra, si mundet ai t'i çmojë meritat t'ueja,

A është ky shoku që keni dasht nga nevoja.

Pra, është shumë e vërtetë që një shok i tillë të mos shoqnohet. Fisnikija ke shoku është një detyrë kundrejt shoqnisë.

Tash le të shohim se si duhet të mbahet shoqnia dhe

se si me e përjetsue atë për deri sa t'a ndajë vdekja. Ciceroni thotë, shoqniya e vërtetë jeton mbi parime të rrepta nderi e virtuti. Kjo jo vetëm forcon e përparon dashtunin e vërtetë shoqnore, por gjithashtu e mban atë të ngushtë e të zjarhtë për deri sa dora e hekurt e vdekjes t'i këputi zemrat e bashkueme n' atë mënyrë.

Kurrë mos i zbuloni të mësheftat e shokut t' uej, pse ai n' asnjë mënyrë nuk jua falë këtë mëkat edhe sikur të jeni pendue e dëshprue përmasandej. Nji gjë e tillë shkatrron bile themelet e shoqnisë s' uej, dhe shumë shpejt ndërtesa e saj rrëzohet që kurrë për t' u ngrehun mâ. Ai ju zgjedhë juve nga shumë njerës që e rrethojnë për me ju shprehë e çelë gjithë sekretet e veta. Do të numurohesh vepra mâ tradhtore, nga ana e juej, sikur t'ia zbulojshit sekretet e zemrës së tij.

Më ep mue një shok besnik, të dashtun e të vërtetë dhe merri se t' i kam falë gjithë të tjerët çka ngelin. Vlefta e tij është mâ e çmueshme se gurrët e xhevahirtë dhe merita e tij s' mund të peshohet.

Me qëllim për me e kuptue mâ mirë subjektin, na duhet me qenë të zot me dallue në mes të shoqnisë falso e t' asaj së vërtetës, në mes shoqnisë e të dashtunisë e në mes të shoqnisë e të njoftunve. Ju e dini se ka dy fuqina në botë, vesi i keq është njâna, e cila qëndron në kulm, dhe tjetra është virtuti që mâ dendun gjindet nëpër kasolla e banesa të përvujtuna të të vobegteve. Vesi është një axhent i keq, që farën e ka të mbjellun në këtë botë, por virtuti e shkelmon fuqin e tij me zemër të plotë. Shpesh mos-kujdesi e bân që në fillim gabojmë dhe e njehim njânën për tjetrën. Po, egjëra dhe gruni dendun qëllojnë në një fushë të padiktueshme prej synit të njerzisë. Duhet të sillni në mend se mâ në fund ka një diferencë të madhe në mes të të dyjave dhe ju e unë mund të gjykojmë e t' a peshojmë njâni tjetrin fare kollaj. Tash pra, unë mendoj se mos shoqnimi ka farën, rritjen e ushqimin e tij në vese të këqija. Ajo buron nga immoraliteti e poshtnimit, të cilët për ditë bâhen mâ të fortë në epshe, pasione e vetëpëlqim. A ka ndonjë që e ndjen të vërtetën e kësaj në vehten e vet?! Oh! Ju kërkoi përvujtnisht e me sinqeritet për me i shkelmue gjithë prangat e kësaj skllavërije, dhe bahuni njerës të lirë tue qëndrue të pa tundun mbi themelet e virtutit. Në qoftë se ju nuk e shkundni atë edhe për disa kohë, mund të

jetë shumë vonë nesër. Shoqni e vërtetë, si e thotë Ciceroni, shpirtërohet nga ndjenjat e nguluna të respektit e të virtutit dhe rritet në tokën e vet. Të lumtun janë ata prej jush që e kanë provue vetë.

Pra mund të na bâhet një pyetje, a nuk difton shoqnija dashtuni dhe kjo e fundit të parën, ku është diferenca pra? I përgjegjemi, se sikurse fëmija që lind nga mëma, kështu edhe shoqnija lind nga dashtunija. Dashtunija është diçka më e shkëlqyeshme e mund të prodhohet vetëm nga bashkimi i ngushtë e i gjatë. Me thënë unë e dashuroj gruen t'ime, (ose shokun t'im,) tue pohue se unë kurrë s'e kam pà para se të marthohem me 'të, është padyshim qesharake, me gjithse ajo mund të dalë e bukur e sjellshme. Çdo lloj dashtunije vjen nga bashkimi ose marrëdhënja e ngushtë që kemi me 'të. Mikrobi, natyrisht, është në zemër, porse është i pashvilluem. Fara e vogël i ka të tana pjesët e pemës në një mënyrë fare të zvoglueme, bile edhe gjethet, porse ajo duhet të banojë në tokë para se të mund të mbijë e të rritet në pemë.

Tash kujtoj se e keni kuptue ndryshimin në mes të shoqnisë e të dashtunisë. Nuk nevojitet t'jua spjegoj ndryshimin në mes të një të njoftuni e të një shoku, pse ajo është e qartë nga shënimet e sipërme.

Të lumtun janë ata që kanë gjetun bashkë-shortët e vet të ndershëm, të mirë e besnikë se me gjithatë është shpresa e një dashtunije të vërtetë në të ardhshmen.

S'ka gjâ më të kândshme në fushën e jetës,

Aqë e gëzueshme sa grueja e fletës;

Kur dashtunija bashkohet me jetën bashk-shortore,

Ajo e përjetson lidhjen e martesës Hyjnore.

Padasht kam cekun seksin e bukur në subjektin t'im, pse kam një respekt të thellë për 'të, por jam i huaj nga shumë zakone e mënyra shoqnore të krahinave të tjera, prandaj nuk po thellohem. Kjo është një nga çashljet me rëndsi që duhet të bisedohet.

Për t'a përmbledhë subjektin t'im, do t'a paraqes atë në formë të një alegorie e pastaj do t'a përfundoj me një këshillë të mirë, me shpresë se do të lerë përshtypjen e duhur:

Një herë, pa pritë e pa kujtue, isha transportue në një tokë që paraqitte vetë bukurinë. Pamjet e hijshme e të përsishkrueshme t'atij vendi diftonin një kombinezon arti të

mbaruem, që ia kalonte çdo pamjeje natyrale e që talenti i em s' ishte i zoti të përshkruente as edhe pjesën më të vogël, si me thënë, një majë gjylopâne. Njerzit e dashtun t'atjeshëm, me tërheqje të pashëmbëllt, të diftojshin njerin më të vërtetë që kurrë s' mund të jetë arrijtun në këtë jetë. Me i ndalue hapat atje s' ishte një gëzim i vogël për një që ka pa vetëm këtë botë t' errët e të frigshme. Kështu tue vazhdue ecjen t' ime përmes bukurive magjike që më qarkojshin, pa pandeh u-gjinda i ndaluem përpara një pallati, i cili më dha të kuptoj se atje banojshin ndjenjësit e drejtë, të bukur e të lumtun t' asaj toke madhështore. Ata paskshin një lloj qeverije, kryetari i së cilës jetonte n' atë pallat të bukur. Unë u-çudita se si të mos kishte roje, ose një njeri të pakën në vend të rojës, në të hyme të portës, me qënë se zotnija i atij vendi banonte atje. Ajo mund të lente të kuptojshë një send, se gjynahu nuk kishte vend n' at bukuri të përbotshme, plot me çka të don zemra. Atje nuk i ndihesh era ligësisë, të mos e zëmë në gojë vargun e vlla-vrasjeve moderne të kësaj jete. Aty nuk i dihesh emni vjedhjes e kryengritjes, as që ish nevoja e nënpunsave që merren me rregullimin e mbajtjen e qetsisë. Mëkati ka njëmijë e një mënyra tradhëtie. Me e vazhdue alegorinë t' eme, unë tue e rrotullue gjithë këtë në mende, kur përnjëherësh pashë disa persona, të cilët i njofta pavështirsi, pse ata ishin shokët e mij. Ata ishin, Dashtunija, Shoqnija dhe Lumtënija. Unë qeshë tepër i çuditun e krejt gëzim kur i pashë ata. Ata formonin kryesinë e qeverisë. Unë pyeta vet-vehten, ishte vetëm një fluturim mendimi që leu në menden t' eme, por shumë shpejt ai u-bâ shkak që të më qartsojë. E dijshe se personat e dashtunisë, ndenjësit e tokës së bukur, ishin qeveritarët e atij shteti plot qetsi e lumtëni të pambarim. Këta ishin shokët e mij aqë t' ambël.

Me thellue nër sendet e bekueme, asnjë formalitet s' m' u desht me bâ aje, bile as ato civilët. Me një buzë-qeshje më kërkuen t' i shoqnojshe dhe unë me gjithë qejf e pranova grishjen e tyne aqë tepër bujare. Ata më diftuen disa sende tërheqse t' atij vendi, monumentat e se Vërtetës, Drejtsisë, të ndershmenisë, dhe shtyllat e fuqisë së Bashkimit e të Veprimit. Që të gjitha ato ishin të shkrueme për bukuri e të tana kishin këto radhë si mbishkrim: Dedikue Dâstunis, Shoqnisë dhe Lumtënisë. Mue më zû syni atje një send ma tepër e që

ishte fare i freskët, të cilin kurrë nuk e kisha pà në botë, ajo ishte Lumtënija, që dukesh në fytyrën e se i cilit, e s'kishte gjà tjetër veçse bujari e durim. Sikur të që e mundun, thashë me vehte, të mblithnja nga gjithë ato rreze e pamje magjike të dashtunisë së përziemërt, plot durim, do të kisha sjellë mjaft me vehte.

Më kot u-përpoqa t'a ndesh prap këtë tokë të bekueme, plot mirësi, me gjithse e pamundun, por neve na është dhënë talent; na të gjithë atë çka nevojitemi për me e bà dashtuninë t'onë të ndriçojë aqë shkëlqimisht sa që e dishrojmë dhe e gëzojmë në shoqni të vërtetë e të lumtun. Fakti është se na të gjithë provohemi në vet-interes e të shoqnisë, porse na në duem të kalojmë një jetë mà të mirë se atë që kemi kapërcye deri tash, mundemi dhe se nuk është e vështirë. Në fund due t'ju them një send mà tepër. Sikur personat në tokën e për-p fytyrueme që ishin gjithmonë së bashku e gëzoheshin në shoq-nimin e njani tjetrit kështu është edhe sot. Ku ka dashtuni ka shoqni e lumtëni; atje ku gjindet shoqni e vërtetë, atje është dashtunija e lumtënija, dhe se kudo që gjindet lumtëni, sigurisht, duhet të ketë dashtuni e shoqni.

Ndonse ju dhe unë mund të mos jemi në gjendje me i zgjat dorën njani tjetrit për shoqni të vërtetë, por akoma mund të bähemi shokë për hirin e t'Amshuemit e të Plotditshmit Perëndi. Ju siguroj, në qoftë se të gjithë ne, qysh sot, e njo-him Atë, do t'a gjejmë jetën mà të dëfryeshme, mà të lumtun për vehte t'onë dhe mà të dobishme për të tjerët. Na, at botë, do të jemi në pozitë që t'i shtrijmë dorën njani tjetrit për shoqnimin e vllaznimin e të gjithëvet. Atëhere kemi me u-pro-vue se jemi me të vërtetë bàmirsa të shoqnisë e të njerzimit, mbarë. Po, vetëm atëhere do të jemi gati të bajmë shokë që të na lenë lamtumirën një nga një e të kalojmë në Përgjith-mounshmeni, tue i ndjekun ata me plot kënaqësi ndër hapat që na lanë mbrapa.

Tash u pafshim me të mirë në ndonjë numur tjetër. uJ uroj të gjithëve sukses në të gjitha punët t'ueja, e çdo gëzim e lumtëni në këtë epokë të re. Lus që ju të jetoni e të veproni si njerës me edukatë, të qytetnuem. Lus të mësoni mirë për me i krye detyrat t'ueja të çdo lloji qofshin me besnikëri. Lus të bahi të gjithë burra puntorë e plot gjallëri; punoni për deri sa është ditë se kur t'erret s' bân dobi.

REDAKSIJA

FAMILJA

NË VITET e para të shekullit XIX shumë problema të ra janë çfaqë nga filosofët e sociologët. Plasja e revolusioneve, ndryshimet e bame nga përmbysja e regjimevet e evolucionit shoqnuer i asaj kohe kanë shkaktue studime e krahasime, me qëllim që të gjejnë se ç'farë ligjësh duhen vû, për me vendosë e stabilizue shoqnitë, të cilat të munden me u zhvillue me rregull, në lulzim, në përparim e në paqë. Frédéric Le Play ka qenë një nga këta sociologë që, tue pa dekadencën e familjes, ka kërkuë një shërim. Për këtë ky shërim duhet të gjindet në ri-organizimin e mbrojtjen e familjes, që është kundërshtarja e fortë e individualizmit revolucionar.

Familja është «celulja shoqnore». Po t'analizohet shoqnija n'elementet e saja, kuptohet se familja është ajo që e përmban këtë element kryesuer e jo individi. Po të kishte vetëm individa, atëhere nuk do të kishte shoqni, sepse ata nuk ndjekin rrugën, që përtrijetën vazhdimisht. Vetëm përtrimja e vazhdimi i familjes formon bashkimin, lidhjen ekonomike e dashnore edhe solidarasinë, pa të cilat shoqnija nuk mundet me vazhdue. Individi është egoist; ai nuk punon për avenirin; ai nuk lidhet me të kaluemen; ai është jashta këtyne traditave, që e bënë shoqni t'organizueme e të fortë.

Ajo që i komunikon shoqnisë jetë e gjallni, është familja, e cila i bënë këto me anën e fëmijvet që përtrijet, me anën e mëshirës e të respektit, që ka për të tjerët, e me anën e dashunisë së përhershme. Bashkimet, ceremoninat e kujtimet e familjes ushqejnë jetën morale të një populli. Në qoftë se i hedhim një sy historisë, prap kemi me gjetë familjen si bazë t'organizimit material e moral. Njerzit në kohët e lashta jetojshin në pyjet pa lidhje nër mjet tyne, pa emën e pa ligj; ata silleshin për të kërkuë ushqimet; ikshin nga kafshët e egra e nuk njifshin as një detyrë kundrejt grues e fëmijës. Porse, kur formuen më vonë grupet familjare, kur baba u-bënë një autoritet i njoftun, kur fëmijët e nipnit u-bashkuën rreth tij, atëher u-krijue bërthama a nyja e parë e atdheut, e tokës së prindvet. Familjet u-bashkuën e formuen fiset e më vonë due-

lën edhe kryetarët e fisevet. Eupatridët në Greqi e Patrisienët në Romë i vûnë bazat e forta atdheut, i cili është bashkimi i familjevet, që nderojnë prindët e stërgjyshnit e vdekun, përgatisin brezat e ardhshëm, u binden ligjvet e mbajnë traditat e mira.

Familja prap është ajo që ka përmetue me ngrehë veprën më të rëndësishme, atë të qytetnimit. Shtetet e qytetet çduken gjatë kohës, porse ideali menduer e moral, që kanë ndjekë e ndjekin njerzit, nuk ka me u-shdukë. Krijesat artistike e përpjekjet drejt së Bukurës janë gjâna të paprekshme e të pakundërshtueshme; ato tregojnë shkallën e qytetnimit të një vendi. Përpjekja për të Mirën ka vazhdue me kohë, edhe njerzit me vûjtjet e tyre kanë mundë me e realizue një zhest fisnik, një veprim të mirë. Të gjitha këto përpjekje kanë pasë vend në familje, d. m. th. që shtytsja e këtyne veprave qytetnore është familja. Kjo ka krijuë pak nga pak ligje e ka lindë moralin; me anën e kësaj nërmjet grues e fëmijvet burri ka kuptue detyrën e misionin e vet.

Mbassi familja ka rëndsi të madhe për qytetnimin moral e material, është mirë me përmendë se cila është familja e vërtetë dhe cilat janë shkaqet, që e damtojnë dhe e shkatërrojnë: familje nuk don me thënë me hangër bukë së bashku e me flëjtë në një shtëpi. Po t' ishte kjo, atëhere çdo pjestar i saj do të zhytesh në punët e veta gjatë ditës e do të këthehesh në shtëpi me hangër e me flëjtë. As një shkëmbim mendimesh, as një dashtuni intime: gjithë se cilit i bâhet zakon me jetue si dishiron e me mendue në vehte; atëhere zhvillohet egoizmi; fëmijët kanë një pamvarsi të teprueme, sa që morali i prindvet nuk influencon ke ata.

Mb' anë tjetër familja e vërtetë nuk është vetëm një vend fizik; ajo është edhe një strehë morali: ide të përbashkta, parime morale të forcume nga dashtunija e prindvet, këshilla e tjera. Vatra familjare qëndron n' autoritetin e babës, në kujdesin e vërtetë të nënës, në bashkëpunimin e vllazënve e të motrave, në mirë-vajtjen e njëni tjetrit, në respektin e nderit familjar, etj. Atëhere besimi i plotë mbretnon ndërmjet tyre, gëzimi dhe idhnimi pjestohet ndërmjet njëni tjetrit. Çdo pjestari, kur ndahet nga shtëpija, fytyra e familjes i ngel në mendje e zëmër. Ai inspiron veprimet e familjes, ndalohet me bâ keq, kurajohet nër veprimet e dobishme e fisnike, etj.

Në pikpamje mendore një familje e tillë ka vleftë, sepse ndihmon e ruen individin; ajo sjell lumninë. Për sa i përket jetës shoqërore prap ka dobi, se vendi e kombi ka nevojë për të tilla celule të forta, që formojnë armaturën e vërtetë të shoqërisë.

Nga ky përshkrim i vogël kuptohet se është e vështirë me pasë këso familjesh. Mirë po nevoja e domosdoshme e interesi shoqëruar e kombtar e lyp që të krijohen familje të mira. Për këtë gjë dubet me i shdukë a përmirsue shkaqet, që pengojnë formimin e përparimin e saj: paja a prika në të holla, vobegsija e tepërt, të marrunit të holla me kamatë, traditat e këqija familjare, spekulimet, tregti me mjete të këqija, grumbullim pasunije në disa familje spekulonjse, mos rregullimi i jetës së puntorit, padrejtsi, ngarkimi i një pune njerzve të pazot, papunsia, spiunazhi, rrena, pijet alkolike, bixhozi, mos me ndihmue të tjerët, grindje familjare, mos edukimi i të rijvet fizikisht, moralisht e mendësisht e çdo demoralizim tjetër.

Në të tilla vënde, ku nuk shijohet ambësija e dashunisë familjare, njerzit kanë të drejtë me qenë të piklluem, me u ankue nga fati i keq i tyre e me vajtue dashtuninë e vërtetë që u ka mungue! Porse mb' anë tjetër nuk kanë të drejtë me assimilue vatrën me katër mure, ku banon njeriu më i mjerë!

Tue marrë parasysh këto gjëna të përpiqemi pra me e përmirsue e me e naltue familjen. Kur të jetë nevoja të sakrifikojmë diçka prej pamvarsisë e dëshirave t'ona për bashkimin e lumninë e vatrës familjare.

SASHI

Parajsi shtrihet të këmbët e māmave (Muhammedi).

R.

Shënim: — Në Nr. 2 të kësaj Reviste, nën artikullin e Z. Sashi, ishte shkrue një shënim nga Redaksia dhe jo nga artikull-shkruesi.

R.

FLETË HISTORIKE (*)

SHQIPTARIZMI JASHTA DHE MBRËNDA ATDHEUT

(PREJ IZET BEBEZIQI)

NGA pjesa e parë e kryetitullit do të mendohet ndoshta, se me këtë studim të vogël do të këm në qellim me parashtrure, pikësparit, uji përmbledhje historike mbi formimin e kolonivet shqiptare ndër viset e ndryshme të hueja. — Jo, nuk e mejtoj këtë gjâ! Qellimi i vertetë i këtij studimi âshi kryesisht me paraqitë se qysh u zhvillue *Ideja Kombëtare Shqiptare dhe pamvarësija e Shqipnis*. Dhe këtu qëndron kuptimi mâ i randësishëm i rrolit t' arbnorvet në viset e shteteve të hueja.

Por, sidoqoftë, përpara se të përmendi meritimet e vep- rimtarisë së shqiptarvet jashta dhe mbrënda Atdheut, dëshroj mâ s' pari të qesë në shesh, afermendsh në vija të përgjithëshme, fatet e dyndjevet arbënore në vendet e hueja.

Kolonistët shqiptarë e lânë plangun e vet, sidomos përpara dhe rrotull sundimit ottoman kryekrejet për tri arsye: *Ngacmimi i parë që sherbimi i tyne me pagesë n' ushtrit e hueja; shlytja e dytë që mbajtja e besimit te krishtenë të tyne; arsyeja e tretë që lakmimi i tregtis*.

Nji bâtuer ose faktuer i katërt i dyndjes së popullit shqiptar që pullsimi i tepër i vendit, gjâ që shkaktonte vorfuin e popullsis në vend-lindje: Ishte përfundimi i arsyetimevet dhe të rrjedhimevet strategjike, demografike dhe geopolitike të lëvizjevet sllave dhe sidomos t' interesavet përkatëse t' imperatoris byzantine⁽¹⁾. Kështu prâ, qysh prej gjysmës së shekullit katërmbëdhjetë shifet ky popull luftarësh dhe barinjësh, tue marrë rrugën me turma të denduna për në Jug, d. m. th. për në

(1) Si burime përkatëse rekomandoj: Dr. Karl Roth «*Geschichte des Byzantinische Reiches*», dhe, *Sozialund Kulturgeschichte des Byzantinischen Reiches*. Sammlung Goeschen-Berlin 1919. «*Isltorija Srba*», napisa Konstantin Jeriçek. Preveo i dopunio Jovan Radonic.-Beograd 1922. — Izdavačka Knjizarnica Gece Kona. — Gjithâshtu: *Geschichte der Bulgaren*, po prej Jeriçekut. Prag.

(*) Na kanë ardhur shumë artikuj me karakter historik e për t' i kënaqur artikuj-shkruesit po çelim në Revistën t'onë një Fletë, ku do të botohen shkrime dhe dokumenta historike. (K. I.)

Thesali, dhe pak má vonë për n' ishujt grekë, saqë, tutje tutje, popullsuen një pjesë të mirë të tokës hellene dhe pjesën má të madhe të Morës. Shqiptarët e parë në Greqi kanë qënë ushtarë me pagesë, të cilët, kohë pas kohe, u bënë kolonistë paqësorë, që má vonë u ndoqën prej të tjervet me qellime të ndryshme. Çfaqja e tyre pikëspari historikisht caktohet rreth gjysmës së qindvjetit katërmëdhjetë. Por, siç na e dëshmon gjurmuesi greko-shqiptar, Furikis nga Megara, kolonistët e parë arbënorë në Greqi shifën këtu në të dhetin kavaljet; në kohën e *Konstantin Porphyrogenetos*.⁽²⁾ Kur *Sulltan Muhamedi* i II-të pushtoi Morën në vitin 1461, ky vend ishte i banuem prej shqiptarvet; aso kohe gjëndeshin edhe gjurmët e mbrame të Sllavëve të Peloponesit. Shqiptarët e Morës luftuen kundra turqvet me një trimni të jashtëzakonshme; shumë prej tyre humbën në këto luftime. Disa syrësh themeluen kolonin arbëreshe të Piano dei Greci, në Sicili. Ende sot këndohet kanga plot dëneshimi dhe nostalgji përkatëse nga pasardhësit e tyre si jehonë kujtimesh së shënhta rreth humbjes s' Atidheut të dytë:

«O e bukura Morëe,
Çë kur të ljeë
Më nëng të pëe!
Atjë kam u zotin-tatë,
Atjë kam u mëmën t'ime,
Atjë kam u l'im vëlà!
O e bukura Morëe,
Çë kur të ljeë (të lash, u ndava tejet)
Më nëng (nuk) të pëe»

CAMARDA AP. 126.⁽³⁾

Tani, në kohën e socëme, arbënorët banojnë vise, të cilat frymëzohen nga shpirti i kujtimevet klasike, si b. f. Atikën, Mëgaren, Hellikonin, Beotin, Argolin dhe Messenien; gjithashtu i shofim n' ishujt Hydra, Salamis dhe Egina. Në qindvjetin e kaluem gjënde një Athinë një lagje e quejtun «*Plaka*». Elementi shqiptar i Greqis, pak nga pak, po shkrihet në botën greke.

Nashti u vjen rradha kolonivet arbereshe: «Dyndja shqip-

²⁾ Mbi Furikin në lidhje me Fallmerayers «Das Albanische Element in Griechendland» do të flasim njëherë tjetër má haptazi.

³⁾ Cituem si pas Dr. Eqrem Çabejt «*Elemente të Gjuhësisë e të Literaturës Shqipe*», Tiranë 1936. F. 189.

tare për n' Itali u zhvillue në perioda të ndryshme të cilat, zgjaten ndërmjet gjymsës së të pesëmbdhetit shekull deri në gjymsën e kavaljetit tetmbdhetë. Kolonistët e parë shqiptarë përmenden qysh në vjetin 1437 ndër katunde të ndryshme të shpërndame; banojnë, të trazuem me sllavë, në Rekanati dhe n' Ankonë. Shtrati i parë shqiptar n' Italin e poshtëme asht një koloni ushtarësh të paguem nën drejtimin e *Fisnikut Dhimitër Reres* dhe djelmve të tij, të cilët i sherbyen mbretit të Napolit, *Alfonsit t' Aragonies*. Në këte mënyrë zënë fill në gjymsën e shekullit pesëmbdhetë katundet e para arbëreshe në *Kalabri dhe në Sicili*.

Mbas vdekjes s' Alfonsit, *Skënderbeu* i dha ndihmë luftime birit të tij, *mbretit Ferdinand n'Itali*; në këtë rasë, një pjesë e ushtrisë ndihmëtare shqiptare nguli banimin e vet n' *Apuli*. Mbasi vdiq *Skënderbeu* në vjetin 1468 dhe mbas pushtimit të vendit nga ana e turqvet, zhvillohet një dyndje e rë në mbretërinë e Napolit, nën drejtimin e djalit të fatosit t'onë, *Gjon Kastriotit*; në vjetët e pastajme ngjanë edhe shumë dyndje të tjera. Asht për t'u përmendë, si më e mbramja dyndje, ajo që ngjau nën mbretin e Napolit, *Ferdinandin e IV-të në vjetin 1774*. (4).

Për sa u përket shqiptarvet në Turki, këjo koloni u krijue ngase shqiptarët zënë vend atje si pjestarë të njëj ushtrie të zgjedhun a po edhe si nëpunës n' administratën turke ose edhe si tregtarë zëjesh të ndryshme. Nuk po e përmendi rradhën e gjatë të shqiptarvet që u mveshën me detyrën e naltë të kryeministrit në Stamboll, si b. f. pësë pashallarët e Qyprilivet, të cilët organizuen dhe mbëkambën krejtë aparatën shtetnuer ottoman si edhe shumë shqiptarë të tjerë me famë, si arhitektin *Mimar Kasimin* etj. etj.

Kolonija shqiptare n' Egjypt zû fill kryesisht nga tepricat e ushtrisë së zgjedhun shqiptare të *Mehmet Ali Pashës* prej Kavalle. i cili, tue qënë vetë, shqiptar, muji me ndihmën e saj t'a lirojë nga zgjedha osmane Egjyptin; ky themeloi edhe dynastinë e soqëme egjyptiane, që është shqiptare. Më vonë u dyndën për n' atë vend shumë tregtarë të krishtënë, sidomos nga krahina e Korçës. Fatet e dyndjevet shqiptare në Rumani dhe në Bullgari po i kapërcej sot për sot njëherë; këtu poshtë po jap vetun një pasqyrë të njëj statistike të vogël, jo të sakët,

(4). Nxjerrë nga disertacioni i Zotni Dr. *Eqrem Çabejs*.

por si përfundim, pak a shumë, i studimeve të mija të deritashme, të shqiptarvet jashta Mbretnis s' onë:

Jugosllavi: Afro 1,200,000 frymë ç' prej Tivarit, Ulqinit, Tuz, Pejë, Gjakovë, Fush' e Kosovës, Gjilan, Tetovë, Kumanovë, Monastir, Prizrend, Strugë, Ohër etj. etj.

Greqi: 250 - 300,000 frymë nepër kolonit e naltpërmenduna e sidomos: Çamëri, Rrethet e Janinës, Kostur, Fllorinë, Grebene, Hurupisht etj.

Itali: 200 - 220.000 frymë ndër 48 katunde: Në Kalabri, Apuli, Basilikata, Abrucët, Sicili, Borgo Errizzo bri Zarës dhe mbeturina në Capo d' Istria.

Turki: 300,000 frymë e lartë: Në Stamboll, Adrianopel, Brusë, Izmir, sidomos ndër rrethet e Ankarës, t' emigruem ndër kohët e fundit, si shkëmbim popullatash, në pajtim me marrëveshtjen e Lausanës (1922) ndërmjet Greqis e Turkis si edhe, *të dëbue dhe të shternguem* prej Sërbis për t' emigruem nga Kosova për në Turki me preteks, se janë «*Turqë*» dhe jo *myslimanë shqiptarë*.

O, fatkeqësi historike!

Rumani: 10 - 13,000: Në Konstancë. Bukuresht. Në Besarabi katundet: Rekakurt. Kurcien, Kuisneli etj.

Bullgari: 3 - 5,000 sidomos në Sofie, Varna, Filibe etj.

Egypt: 5 - 7,000 si pas informatave të mërruna nga Zotni Prof. Vexhi Demiraj, i cili ka pasë vazhdue studimet universitare në Kairo, janë regjistruem afro *njimi familje shqiptare* pranë përfaqësive të Mbretnis s' onë. Jetojnë: Në Kairo, Alexandri, Fajun, Port Seid dhe të shpërndamë nepër Egjyptë.

Amerikë: 20 - 25,000 sidomos në Boston, New York etj.

*
* *

Nashti po hy në thalfin e studimit t' em të vogël:

Të jetë e vërtetë ose jo, shumë histori-shkrues pohojnëse Shqipnija e fitoi lirin e vet kombëtare nga shembërnija dhe rivaliteti i disa grupevet politike të fuqivet europiane; ky pohim është sigurisht i njëanëshëm. Mbetet një gjë e pakundërshtueme, se këjo liri u fitue në një anë nga propaganda e shkëlqyeshme e Shqiptarëve të jashtëm, por në tjetrën anë edhe nga fryma kombëtare të luftimevet kreshnike të shqiptarvet në vendlindjen e vet; fakte, që mjerisht nuk merren parasysh nga historianët e huej.

Prà në mbështetje të letërsisë së shqiptarve të jashtëm dhe të mbrendëshëm, kam në qellim për sa më lejon qarku i

ngushtë i këtij studimi të përmbledhët, me parashtrur, në vija të përgjithëshme, *zhvillimin e Idës Kombëtare Shqiptare është edhe themelimin e shtetit shqiptar*. T'i hedhim prapa një sy, vetimthi historis s'onë:

Mbas vdekjes së Gjerg Kastriotit, Skënderbent, e cila ngjau në motin 1468 në Lesh, krejtë Shqipnija i u shtrur fuqis dhe influencës ottomane. Prej kësaj kohe nisë për Atdhën e ynë ay prapsim geopolitik dhe shoqëruar, i cili vazhdoi dhe vioji deri në ditët e shpalljes së liris kombëtare. Por, n'ânën reale: Shqipëria në kohët të Turqvet u-bë m'e pasurë e m'e-begatë se kurdo; se Shqipëtarët sulëshinë bashkë me Turqit nëpër gjith anët të botës, edhe këthehëshin ngarkuarë me ar e me argjent me armë të vjetëra e me kuaj të bukurë t'Arabisë, t'Egjyptit të Qyrdistanit, t'Ungarisë etj. Me të qënë më trima e më të zotë se Tyrqitë, shkonin edhe nëpër më të mbëdhenjt e më të nderçmit vënde, e kishin më tepër nder se ata vetë Tyrqitë. Vetëm *sadrazem*, do-me-thënë Vezirë të mbëdhenj, janë bërë afro 25 Shqiptarë, edhe më të mirët' e më të dëgjuarët' e atyre që kanë ndëjtur në këtë vënt janë Shqiptarë.⁽⁵⁾ Për hir rrethanash në fjalë, shqiptarët lidheshin edhe më ngushtazi me turqit, sepse: «... Shqiptarët gjeninë në Turqit atë që doninë: gjë, nder, armë kuaj, rrëmbime sa të donin edhe dli sa u duhesh; edhe Tyrqit gjenin në Shqipëtarët atë që donin: trimëri, besë e gjak të derdhurë pa kurcim.⁽⁶⁾ Aqë është e vërtetë e hidhët saqë: «Po edhe ata që mbenë të krishtenë nuk u poshtuanë e të bëhen *Raje* si kombet' e tjerë, po mbajtën armët e nder' e tyre, edhe vininë edhe këta në luftë, e lëftonin bashkë me vëllezrit' e tyre *myslimanë kuntrë armikëve t' Tyrqisë*». ⁽⁷⁾ Shkurt: «Tyrqit gjetnë në Shqiptarët, një shok të luftësë të fortë e të besësë; edhe Shqipëtarët gjetnë në Turqit një zot q'u hapte përpara një shesh të gjerë e të çpënguarë për të bërë gjith' ato q'u donte zemra ⁽⁸⁾ Dhe me Bajazid Pashën: «... Shqiptarët kishinë zënë të marrënë besën' e Tyrqët e të bëhënë *myslimanë që pa rënë Shqipëria në duart të Turqet*». ⁽⁹⁾ Në të gjitha anët e Shqipnis ndertohej

⁵⁾ Shqipëria ç'ka qënë ç' është e ç' do të bëhet? Prej Sami Frashërit. Përshtypje e tretë. Shtypëshkronja «Mbrothësia» Kristo P. Luarasi. Tiranë. Faqe 20-21.

⁶⁾ Idem. f. 21.

⁷⁾ Idem. f. 20

⁸⁾ Idem. f. 20.

⁹⁾ Idem. f. 19.

xhamija. Shqiptari, pak nga pak, pajtohej me mendësin orientale. Madje, tue u endë pas lakmive materiale dhe pas aventurave karrierash të ndryshme, ndërsa turma e bujqvet pas tokës mbasi nuk durohej dhuna e feudalvet, të cilët, pasuroheshin, kohë pas kohe, në kurriz të vogjlís së për vùjtë tue përdorë të gjitha mjetet si mbas parimit: «*hjer i forti të ligut!*» tregtija, bujqësija dhe puna e dorës, deri diku, u lënë në një anë. Po në këte mënyrë, kohë pas kohe, u shpopulluen qytetet më të përmenduna të Shqipnis, si b. f. Durrësi, Shkodra etj. etj. «Hambari i Romës» së dikurshme, Myzeqeja, u kënetizue! Mjerisht, nga pakujdesija administrative turke, me kohë, u përhap gjatë bregut të detit malarja në popullin e shndoshët, fatkeqësisht e favorizuese, për natyrë të veten, ndër këto krahina, aqë dhe më tepër, mbasi mungonte çdo masë hygjienike në kuptimin sociologjik. Por, përposë rrjedhimeve në fjalë, fatalisht, *Shqipnija përjashtojë gadi krejtësisht nga çdo ndikësë dhe influencë kulturore europiane.*

(Vazhdon)

NE GJYKATOREN E H' ALIFES UMER

(Vazhdon nga Nr. 2)

TANI, kur i kaloi gjaknxehtësia e çastit, mbeti i tmeruar për çka bani, e goditi rëndë hidhërimi i fajit. I dha funt jetës të njëj vëllait dhe shkeli ligjin e shénjtë të fësë islame. «Jeta, nderi dhe pasunia e njeri tjetërit janë të shénjta dhe nuk mund t'i shkelni.» A nuk qe kjo porosia e fundit që i bëri Profeti botës islame në kohë që do të ndahej nga kjo jetë? Këto fjalë djalit i tingëllojshin pa pra në veshë; e mbuloi turpi, thoshte me vehte që ishte një trathëtor dhe një musliman pa kurrëfarë vlere; duke marrë jetën e njëj vëllai nuk e mbajti emanetin e fundit të Profetit, që i la çdo muslimani.

Ishte tepër vonë, çka u-bë u-bë, tani puna ishte se ç'do të bënte? Nuk u-ndoth njeri që t'a shifte. A t'ikënte për të shpëtuar kokën? Po të dorëzohej e priste litari, ç'do të bënte?

Kështu mejtohej me vehte dhe po thua qe gati që t'anonte nga instinkti i vetë-mbrojtjes, duke vendosur që të arratisesh e t'i shpëtonte dënimit të ligjit; duke u-bë gati për t'u arratisur i erth një zë nga thellësia e shpirtit e i thotë, jo! kurr; nuk meriton për një musliman t'ikij e t'i shpëtojë dënimit të ligjit. T'i shpëtosh ligjit të kësaj bote do të thotë mashtrim e trathëti, nuk meriton për një musliman që të mashtrojë e të trathëtojë. Shkoi drejt në vilë të shehut dhe e dorëzoi vehten si vrasës i kopshtarit plak.

Në këtë kohë mbretënonte në Medine I Madhi Umer si Halife i Muslimanëve: drejtësia e pa anësia e Tij ishte me famë; nuk mbante as të lartë as t'ulët, as mik as armik; kur e gjeti të birin në një faj pat urdhëruar të dënohej me vdekje. Në një të tillë gjyq po e dërgonte shehu djaloshin të gjykohej, të dy djemt e plakut e shoqëruan për në gjyq.

Mbas njëj udhëtimi të gjatë mbërritën në Medine, si ankuësit edhe i pandehuri, ju paraqitën H'alifes», i Cili ndohej në gjykatore bashkë me suitën e Tij. Salla e gjyqit t'Umerit nuk ishte as pak si sallat e gjyqevet moderne, me madhështi e me stoli. Thjeshtësia ishte shpirti i Fesë Islame në këto kohë t'arta; salla e gjyqit nuk ishte tjetër veç faltores të mbuluëme me kashtë; as gjykatësi nuk ishte veshur me rroba zyrtare të kushtuëshme; me rroba të handruara, por të pastërta, Halifi rrinte i pështetur përmbi një shtresë prej hurmi; me gjithë këtë pamja e Tij i shtinte tmerin fajtorit, drejtësia e Tij një për të gjithë, ishte mprojtësi i të dobëtvet dhe tmeri i tiranëvet a i shtypësve; trupi gjykuës ishte i thjeshtë, përbëhej prej grumbullit të muslimanëve të divotshëm që kishin ardhë për t'u falë në xhami; të gjithë ishin njerëz që kishin frikë Zotin dhe duajnë drejtësinë e pa anësinë. Përpara një gjykatësi dhe një trupi gjykuës të tillë paraqitej djaloshi i akuzuar për vrasjen e plakut, rojtësit të kopshtit. I drejtohet Umerit vëllai ma i math duke filluar nga ankimi «Emiru-l-Muëmininë», «Sundimtar i besnikëvet!», i thotë: «Ky njeri qëndroi n' oaze t'ona për pushim mbassi, e zuri gjumi, i hyri deveja në kopshtin e Shehut t'onë dhe bëri mjaft dëm në vreshta, baba i jonë e nxorri kafshën dy herë, po ajo ardhi përsëri; të tretën herë duke e qëlluar me shkop pa dashur e goditi liksht dhe e la të ngordhur; qe fatkeqësi, u-bë pa dashur, ai nuk pati ndonjë qëllim t'a vriste, vetëm deshi të kryente

detyrën duke e nxjerrë nga dëmi; këjo ishte detyra e tij dhe për këtë paguante shehu. Zotnia flinte kur i u vra deveja dhe nuk dinte gja kush i a vrau. Po të donte baba im mund t'a kishte mohuar që s'kishte dijeni mbi ngordhjen e deve; po ishte musliman i vërtetë dhe një ndjekës i saktë i Profetit; dhe me gjithë që kërkush s'e pa nuk mund t'a mohonte. Nuk i hithte dot njollë emërit të Fesë Islame dhe të Profetit dyke gënjyer. Shpesh herë na kallëzonte që muslimani duhet të jetë i drejtë le t'i dalë si t'i dalë fundi. Të folurit të vërtetën ishte diamanti ma i shkëlqyer në karakterin e Profetit. Edhe përpara se të bëhej Profet që titulluar prej të gjithëve me titullin «El-Emijnë», «I Drejti, Besniku»; një njeri me të tilla ndjenja të pastërta islame s'mund të bjerë aq posht sa të gënjejë për të shpëtuar jetën e tij; ju afrua djalit dhe i kallëzoi pikë për pikë ç'kishte ngjarë duke shfaqur edhe hidhërimin e tij; po ky në vënd që t'i çmonte singeritetin islam ju vërsul për gryke dhe e mbyti pa të drejtë.

(Vazhdon)

H. SELAMI

Jehu i Poezisë

«Ove più è bellezza ivi più è verità»

Piklat e voesës, të shpërndame nepër fijet e barit të njomë të fushave, dukeshin për Omerin si një dorë e mëshehtë qi qindiste prorre kolle vjollcash e lulësh.

Poeti, është jehu i popullit të vet. Ai gëdhenë apotheose të pa-krahasueshme lavdije.

Dashurin e vashës e këndon në gojën e krejtë një populli; dhe ngjyrat e hijshme më të cillat veshë vargje të zgjedhun, i shijon ndër dritat transparente prej kah nxjerrë edhe tingujt e njaj melodije hyjnore.

Arti i poetit, është një muzikë e mallëngjyeshme qi vrullon e kumbueshme deri ndër zemrat më të vdekuna.

Natyra, metri, rithmi dhe fantazija — ja telat me të cillët këndo muzen dhe dashurin poeti.

Berlioz, kallron në një letër të vet se kërkonte prej sa kohe me përshkrue botën e ujnave. Nji ditë, në sa po shetitte, u vënd

brij lumit Tevere. U vû me admirue. Lëshoi lapcen në tokë dhe ra në not. Zbriti deri te shkambijt mbulue me bar mushti, kû peshqit dredhoshin me gjetë shujtat. Kur duel në breg, thiri:

— Sa poezi të bukur më fale o Tevere!

Schiller i shkruente Goethe-s me 1795:

— Atë çka dishroshem me vû në varg tash sa kohë, e gjeta në boçën e njaj drandofilleje.

Janë orë të mrekullueshme e një qetësim trupi — shenonte Bandelaire — kur ndiesinat rithmojnë njëj zâni me tingujt e natyrës, me qiellin e bruzët në të cillin çdo notë, duket si një jonë muzike dhe çdo ngjyrë reflektohet mâ ambël në shpirt.

FADIL KARAKAÇI

Facoltà di Lettere

Padova, 11 Nanduer 1939

Kr. e Kom. Musl. Shq.

Nr 670 d. 26-XI-939-XVIII

Tiranë, me 21-XI-939-XVIII

QARKORE

**Të gjithë Kryemyftive, Myftive, N-Myftive,
e Imametnive në**

SHQIPNI

Kemi patur rastin të dëgjojmë se disa predikuës kanë predikuar se të dhënët të holla me kamatë, tue përdorur atë systemin e dredhisë (hilé) që disa kesaj dredhije i kanë futur dhe shtuar dhe një bisht legjitim (Sher-î), është e lejuëshme, d. m. th. ajo vepër e bën të lejuëshëm kamatën që me fjalën e qartë dhe të prême (NassiKat-î) të Perëndisë, u-madhëroftë Emëri i Tij, (We Harreme-Rriba) që d. m. th. E ndaloi Kamatën, është kryekëput e ndaluar Me predikimin e atij sistemi që do t'a spjegojmë më poshtë te bëhet e lejushme (Halal', ky lloj predikimi ose spjegimi është një gabim trashanik sepse, duhet te kuptohet prej të gjithëvet që, ne Kur' an gjën-

det e ndaluëme me një argument të premë; me të vënit në veprim të tillë dredhi a hilé, të bëhet e lejuëshme s' është tjetër veçse një tronditje e urdhëravet të Sheriatit aqë sa shkakton mos besim ndaj urdhënat e Sher-i Sherifit. E për të drejtuar këtë keq kuptim, ca më mirë absurd, u-shtërnguamë të qarojmë atë çështje a problemë për t'i dhënë dritë si opinionit ashtu dhe besnikëvet të gabuar si edhe t'u dëftejmë lartësinë plot logjikë t'urdhëravet Kuranore e për me i a arritur kesaj pike do t' u rrëfejmë çështjen si dhe logjikkën e ndalimit:

Në kohën e parë, pré islamike ose t' injorancës, qe bërë zakon ndër arabë me dhënë të holla me kamatë: të 100 fr. ar. për 110 fr. ar. me një kohë (afat) për një vit. Por, kur vinte koha e pagimit dhe debitori nuk kishte të paguajë, në marrëveshtje të kreditorit me debitorin shtohej afati ashtu dhe kamata, kështu u-përsëritëte shumë here dhe kohë mbas kohe aqë sa kamata arrinte të kapërxejë kryegjënë. Këtë vepër Islamizmi e ndaloi rreptësisht me dispozitat Kuranore, ku urdhënon: *We Harreme-Rriba*.

Arrësÿënat dhe logjika e ndalimit

Feja Islame është themeluar për mbi bazën e bujarisë, mbi parimin e ndihmës reciproke kundrejt njeri tjetrit, mbi forcimin vëllazëror, tue punuar kolektivisht për zhvillimin e tregëtisë, Industrisë, Bujqësisë, Zejtarrisë e pa kundër shpërblim dhe mos marrje të pasurisë së tjetrit pa të drejtë.

Pra, kur të merret dhe të lejohet kamata shkatërrohen të gjitha ato që u-thanë më lartë sepse një njeri po të mësohet me kamatë, dhe sheh se fiton dhe siguron ushqimin tue përdorur atë, ai largohet nga tregëtia dhe nga formimi i shoqërisë për me lëshkuë kapitalet e me zhvilluë shoqërirë industriale, me zhvilluë zëjtarinë e me ngrehun fabrika të ndryshme që kështu të gjithë njerëzit të përfitojnë. Kapitalistët tue lëvruar kapitalet, të vobëktët tue punuar si punëtorë, në tregëti e në fabrika industriale, në këtë mënyrë stabilizohet e sigurohet jetasa e të gjithëvet dhe zhduken paudhesitë e kusëritë, grabi-

tjet, ligësit e të tjera dhe shtohet bujaria, dashuria dhe bashke punimi vëllazëror njeri me rjetrin.

Kamata, me që punohet dhe përdoret nga pasanikët dhe të vobektët, pra, i pasuri a pasaniku me anë të ka matës shtyp të vobektin tue i marrë pasurinë atij pa të drejtë, kur Feja sigurimin e pasurisë e ka në një gradë me sigurinë e jetesës njerëzore.

Shihet në librat e Jurisprudencës (Fik-hut) se një dijetar ka treguar një system dredhije (Hilé) për lejimin dhe marrëjen e kamates, kështu:

Kur x i ep me kamatë y 100 fr ar. dhe dëshëron të marrë, për të 100 fr. ar., kamatë, simbas godisë që do të bëjnë, fr. ar. 400/0; në lidhëjen e aktit i ep a i dorëzon në dorë 100 Fr. ari dhe për të 400/0 Fr. ari, dhënësi i shet marrësit një plaçkë — libër ose tjetër — për 40 Fr. ari dhe mandej ky i a bën dhuratë këtë plaçkë dhënësit dhe akti bëhet për 140 Fr. ari, 100 të marra hua dhe 40 t'ardhura nga vleftha e shitjes të stipuluar e kështu predikuësit këtë system e konsiderojnë një liri legalë për kamatë. Por, konsiderimi është i gabuar krejtësisht dhe kryekëput sepse dijetari në fjalë nuk ka patur kurrë për qëllim lirimin e kamatës së një gjëje që ishte ndaluar me urdhër të prërë të Kur'anit që nuk mund të ndryshohet kurrë, dhe se me një të tillë predikim shkatërrohet — Zoti na ruajtë — mos besimi në dispozitat kuranore që bijë një anarshi në Fenë Islame. Qëllimi i atij dijetari është ky:

Si dihet në Sheriat gjëndet një dispozitë që thotë se: ajo gjë që është e ndaluar marrëja është e ndaluar dhe dhënëja. Pra, hua-marrësi me kamatë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatësit tue thënë se sa do që unë, me aktin e firmuar nga ana ime, kam pohuar se kam marrë 100 Fr ari hua e 40 Fr. ari kam blerë një plaçkë edhe nuk i kam paguar e kështu të gjithë shuma figuron 140 Fr. ari të detyruëme për të paguar unë, por mbassi në realitet plaçkë s'kam marrë, të 40 Fr ari janë kamatë e për mos të figuruar kamatë është bërë ky stipulim dhe në bazë të dispozitës (marrëja e një gjëse që është e ndaluar, edhe dhënëja është e ndaluar), prandaj, kërkoj

të ndalohet hua dhënësi nga kërkimi i të 40 Fr. ari që figurojnë si vleftë e shitëjes, ose të m'i kërtojë në rast që i ka marrë hua dhënësi. - Gjykatësi këtë padi të hua marrësit nuk ia ndigjon me qënë që ka një pohim të qartë që është debitor për fr. ari 140... e kështu e ndalon hua marrësin nga padia; por nuk duhet të kupëtohet se me këtë system kamata bëhet e lejuarshme e nuk ka mëkat, përkundrazi mëkati vazhdon edhe nuk falet kurrë. Si këjo është edhe çështja e Zeqatit që tregohet ne librat e Jurisprudencës (Fik-hut), ku thuhet se pa mbaruar viti i përdorimit të mallit të zëqatunëm në dorë të pasanikut, ky, një ditë më parë, pasuninë që i përket Zeqatit i a bën dhuratë fëmijës edhe shpëton nga Zeqati me pretendim se nuk u-plotësua i tërë viti i përdorimit në dorë të tija. Këjo s'është tjetër veçse një vepër dredhake që ndalon tagra mbëledhësin (Xhabi) nga kërkimi i Zeqatit edhe jo se shkarrohet i detyruëmi nga detyrimi i Zeqatit. Gjithënjë ky, si ai i kamatës janë përgjegjës e mëkat bënës.

Predikimet e bëra gjer sot i kanë hedhur një nollë si dhe një përbuzje besimit kuranor si edhe kanë shkaktuar thash e thëna ne opinion kundër atij besimi. Pra, urdhërojmë spjegimin e çështjes si më sipër dhe porosisim të gjithë predikuësit që predikimet t'i bëjnë me studime t' imta e me gjykim logjik dhe menduër; në rasë të kundërt do të jemi të shtërnguar me marrë masat e duhura kundër atyre që veprojnë kundra kësaj porosije. Veçanërisht Krye-myftitë, Myftitë e Nen-Myftitë e kanë për detyrë të kontrolluarit të predikimevet të predikuësve e mos me lënë të bëjnë predikime si më sipër, absurde.

Kryetar' i Komunitetit Musliman
DR. B. SHAPATI

TE NDRYSHME

Tiranë, 25-XI-1939-XVIII

Sod *paradreke* filluen rregullisht mësimet në Medresen e Përgjithshme të Komunitetit Mysliman Tiranë, në prani t' autoritetve ma të nalta fetare, të 100 bursistave të Komunitetit e 30 të jashtëmeve.

Para fillimit të mësimëve, n' orën 8.30, u-bà ceremonija përkatse tue u mbajtë fjalimi i rastit prej Drejtorit të Shkollës Hirsis Tij H. Ismet Dibra dhe prej Eminencës së Tij Kryetarit të Komunitetit Dr B. Shapatit, i cili u foli nëansave mbi rëndësinë qi ka Instituti në pikpamje fetare dhe mbi përkrahjen e respektin qi është tue i dhanë Regjimi Fashist këtij Instituti Fetar. Mandaj oratori lajmërojë veçanërisht studentat se Partia Fashiste Shqiptare, me ndërmjetsinë e Inspektorit të P. N. F., comm. Giovanni Giro, ka kërkuë një imamë, d.m.th. prisë fetarë, për Bataljonin e këmishave të Zeza të Tiranës. Ky lajmë prodhojë një kënaqsië të madhe si ndër studentat ashtu edhe në trupin Mësimuerë. Thëksojë se në vjetin 1939-40 në Medrese do të bahet një organizim i rië tue vue në veprim programin nandë klasësh në vend të shtat klaseve qi është tani. Me përkrahjen e Regjimit Fashist dhe sidomos të ndihmës së pa kursyshme të Shkëlq. Tij Mëkambësit të Përgjithshëm edhe këjo mungesë u plotsue në vjetin fatlumë të XVIII t' Epokës Fashiste.

Njikohsisht mësohet se gjuha Italishte është përmbledhun në programin mësimuerë të këtij vjeti tue fillue në klasën e tretë e deri n' atë të fundit.

F E S T A T

Më 28 Tetor qëlloi festa e XVIII Vjetorit të Fashizmit, i cili u-festue me solemnitete e çfaqëje të dukëshme gëzimi prej gjithë popullit të Kryeqytetit. Këmishat e zeza ishin ato që i epshin pamjen ma madhështore festës nga të gjitha anët.

Më 11 Nanduer u-kremtue me një dukje të çquem prej gjithë popullit të Tiranës Ditë - Lindja e M. T. Mbretit Peranduer. Në Faltoren e Vjetër të Kryeqytetit ishte mbledhun një mori populli, mbrenda dhe jashtë, ku me njëberë ia mërrijti Mëkambësi i Përgjithshëm i Mbretit Peranduer në Shqipni, Shkëlqesia e Tij F. Jacomoni, i pritun prej Autoriteteve ma të nalta të Kom. Musliman, tue pasë në krye Dr. B. Shapatin. Fjala e rastit u-mbajt prej Hirsisë së Tij M. Mullahi, i cili bani edhe një lutje të gjatë në gjuhën shqipe për jetë-gjatsinë e Udhëheqsave t' Imperatorisë Italiane dhe për prosperitetin e popullit të saj. Ceremonia u-mbarue me një gëzim të gjallë prej të gjithëve. Shkëlqesia e Tij Mëkambësi i Përgjithshëm la Xhaminë me buzëqeshje, i përcjellun prej Eminencës së Tij, Kryetarit të Kom. Musliman dhe prej Kryetarëve të Sekteve të tjera, i përshëndetun në mënyrën Fashiste prej gjith popullit.

Për nder të kësaj dite të paharueshme, Shkëlqesia e Tij F. Jacomoni shtroi një darkë madhështore, ku ishin ftuem përsonalitetet më të nalta qeveritare si dhe Eminenca e Tij, Dr. B. Shapati.

Më datën 13 Nanduer ndodhi Bajrami i Math, që u-festue me një gëzim të jasht-zakonshëm prej gjithë

Elementit Musliman; kjo festë u-mbajt prej të gjithë Muslimanëve pa përjashtim, shenjë kjo që vërteton mbarësinë e popullit, i cili kurdoherë e ka kuptue vlerën e bashkimit vllaznuer të fesë së vet.

28 Nanduer, 1912 është data historike, në të cilën Shqipnija fitoi independencën e saj. Kjo na përkujton dëshmorët, që dhanë jetën për Atdhe. Kjo ditë e pavardekshme e madhështore për Shqipnin t'onë të Shtrenjtë, simvjet u-kremtue me një madhështi shembullore. Në Xhaminë e Vjetër u kënduen Hymne fetare prej korit të Medreses e fjalën e rastit e mbajti Hirsia e Tij M. Mullahi. Ceremonia e kësaj dite fatlume preku thellsisht të gjithë zemrat e popullit.

Na kanë ardhun shumë artikuj mbi randsinë e kësaj dite, mirë po Revista ishte vû në shtyp, e kështu nuk mundëm t' i botojmë.

Një humbje me vlerë për Kom. Musliman :

Nënmyftiu i Fierit, Ibrahim Buharaj, më 14 të k. m. ndërroi jetë. I ndyeri ka qenë i pajosun me një kulturë të naltë fetare e morale, me vetija shembullore dhe me një shpirt real për bashkimin Kombtar. Funerali u përcuell prej personaliteteve të vendeve të ndryshme në mes të cilëve shquesh Eminenca e Tij, Dr. B. Shapati e persona të naltë fetarë e civilë të prijmun prej Bandës së Bashkisë atjeshme. Mbi vorrin e të ndyerit u mbajtën dy fjalime të pikllueshme dhe u vunë kunora. Humbja e të ndyerit lã në pikëllim familjen e vet dhe në hidhërim miqtë e dashamirësit e shumtë të tij.

«Kultura Islame» i dërgon familjes së të ndyerit ngushllimet e veçanta për prehje shpirtnore.

Posta e Jonë

R. H. B. (Lyceist) Shkodër. S' mundëm t' ju plotsojmë dëshirën këtë herë, pse Revista ishte vû në shtyp kur na erdhën artikujt e rastit. Mâ vonë.

P Peshk. Vlorë. Pajtimin e muarrmë; dy numurat jua dërguem; dëftesën me postë. Falenderime.

F K. Padova. Revista e jonë është e rinisë dhe e intelektualve.

Xh Laçej, Shkodër. Nuk mundemi t' ju plotsojmë dëshirën, mbassi pajtimtarët janë shtue aqë tepër sa s' pandehshim.

Q. G. Vajguras. Pajtimin për një vit e muarrmë; Nr. 1 jua çuem me postë; mirë njoftje për çka na shkruiejshit; do përpiqemi me sa të mundemi.

V I. Alkovaj (St.) Kairo. Kuranin etj. i muarrmë; falem nderit.

A. Z. Nën. Permet. Nr. 78: Mund të regjistroni këdo, por pajtimtarë. Ç' na shkruiejshit me shkr. Nr. 92 jua dërguem.

T. E. Jergucat. Ju falem nderit për sa na shkruiejshit, por çdo gjâ bâhet gradualisht, mbassi s' kemi element. Na pëlqen një studim i atillë, mirëpo mungojnë mjetet. Puna e mirë bâhet ngadalë.

A. D. (Ag.) Elbasan. Ju falem nderit për kujtesën e disa pikave të keq-kuptueme, të cilat me kohë do të shvillohen.

H. R. (Myf.) Peshkopi. Do të mundohemi t' i kënaqim edhe lexuesit me kulturë mezatare, t' ulët.

J. H. (Konf.) Tepelenë. Nuk jemi përgjegjës për abonistat e përparshëm, shifni « Lajmërimin » në Revistë. Emnat e Pajtimtarve, që na keni çue drejt për së drejti i kemi në rregull.

F. A. Burrel. Për sa na shkruiejshit ja u dërguem.

L A J M Ë R I M:

Agjentët e Revistës s' onë, si pas rregullit, do të kenë vetëm 10 % skonto nga shitja me copë.

Pajtimtarët që ndërrojnë banim si dhe ata që dëshërojnë të pajtohen, lypset t' i shkruiejnë kësaj Administrate.

SHTYPUN NË SHTYPSHKROJEN «SHKODRA» — TIRANË